

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5501
E mërkurë, 13 qershor 2018
çmimi 0.40 €

Apostolova kërkon angazhim më të shtuar për zbatimin e MSA-së

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

MOS VDEKSHA SA TË JENË NË PUSHTET HASHIMI DHE BEHGJETI! F. 11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

HARADINAJ: NGA RRRITJA E PAGAVE MË SË SHUMTI FITOJNË GJYQARËT DHE PROKURORËT F. 5

KOSOVA NDERON USHTARËT E RËNË TË KFOR-it ME MEMORIAL NË QENDËR TË PRISHTINËS F. 6

EKONOMI

KOSOVA PËRFITON 10 MILIONË EURO NGA KE-ja PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË F. 9

POSTA KËRKON NGA DEPUTETËT TË MOS E VOTOJNË NENIN 11 DHE 62 TË DRAFTILIGJIT PËR SHËRBIMIN POSTAR F. 8

KULTURË

GRATË SHKRIMTARE F. 13

Elife LUZHA

SPORT

DRITA DHE PRISHTINA MËSOJNË KUNDËRSHTARËT NË EVROPË F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", ISMET SALIHU

Sistemi i drejtësisë ende nuk ka arritur të pavarësohet

Profesori i së Drejtës Penale Ndërkombëtare, Ismet Salihu, ka thënë se ende sistemi i drejtësisë në vendin tonë nuk e ka arritur konceptin e pavarësisimit për faktin se ende ka interferime dhe ndikime të politikes. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se prania e EULEX-it edhe për dy vjetët e ardhshëm është një lloj mekanizmi që në një masë e mbron sistemin e drejtësisë prej interferimeve politike të njerëzve që janë në pushtet. Salihu ka pohuar se nëse Kosova nuk do të tregojë rezultate të mira në sistemin e drejtësisë, atëherë ka shumë gjasa që edhe pas dy vjetësh sërish EULEX-it t'i vazhdohet mandati. Ai ka thënë se edhe Gjykata Speciale është një ndër shkaqet dhe arsyet që ka ndikuar t'i vazhdohet mandati misionit të EULEX-it



Pacolli zotohet se do të ketë kuotë të barabartë në misionet diplomatike

Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka raportuar të martën para anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, për procesin e njohjeve,

procesin e aplikimit në Këshillin e Evropës, për emërimet në shërbimin e jashtëm, si dhe për procesin e rotacionit. Ai ka thënë se reformimi i plotë i MPJ-së do të kryhet deri në fund të



mandatit të tij si ministër, duke premtuar se stafi diplomatik do të jetë 50/50, gjysma e diplomatëve të emëruar politikisht, kurse gjysma tjetër e karrierës

Parlamenti Evropian konfirmon përkrahjen për liberalizimin e vizave

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka nisur vizitën zyrtare në Strasburg për procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Ai është pritur në një takim nga presidenti i Parlamentit Evropian, Antonio Tajani, nga i cili ka marrë përkrahjen e plotë për procesin e liberalizimit të vizave



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Fleckensteini: Të hapen negociatat me Shqipërinë

BRUKSEL, 12 QERSHOR - Këshilli Evropian do të vendosë pas pak ditësh nëse dot'i hapë bisedimet e anëtarësimit me Shqipërinë apo jo. Mes vendeve anëtare përflitet se janë 2-3 shtete skeptike që mund ta bllokojnë çeljen e negociatave, me argumentin se Shqipëria nuk ka përmbushur kriteret e vendosura. Por për eurodeputetin Knut Fleckenstein, që është gjithashtu edhe raportues për Shqipërinë në

Parlamentin Evropian, kushtet për hapjen e bisedimeve janë plotësuar nga Tirana. "Në Shqipëri ka pasur progres të qartë dhe çështjet sa i takon sundimit të ligjit po shkojnë në drejtimin e duhur dhe ndoshta edhe më mirë sesa në disa vende brenda Bashkimit Evropian. Prandaj, ne duhet t'i hapim bisedimet e anëtarësimit me këtë vend", apeloj ai në PE.

Një tjetër thirrje për Këshillin

kishte edhe për Kosovën. "Të mos harrojmë që kriteret për liberalizimin e vizave janë plotësuar tashmë", u shpreh Fleckenstein. Eurodeputeti gjerman kërkoi edhe hapjen e negociatave me Maqedoninë dhe avancimin e tyre në kapitujt e tjerë për rastin e Serbisë dhe Malit të Zi. "Duhet të dërgojmë në Ballkanin Perëndimor një sinjal të qartë se cila është qasja jonë për këtë rajon", ka thënë Fleckenstein.



Parlamenti Evropian konfirmon përkrahjen për liberalizimin e vizave

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka nisur vizitën zyrtare në Strasburg për procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Ai është pritur në një takim nga presidenti i Parlamentit Evropian, Antonio Tajani, nga i cili ka marrë përkrahjen e plotë për procesin e liberalizimit të vizave



PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka nisur vizitën zyrtare në Strasburg për procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Të martën ai është takuar me presidentin e Parlamentit Evropian, Antonio Tajani, me të cilin ka diskutuar për hapat që pritet të ndërmerren gjatë muajve në vijim, për përmbylljen e procesit të liberalizimit të vizave.

Kryeparlamentari Veseli tha se ka marrë zotimin e Tajanit se Parlamenti Evropian është i gatshëm të procedojë vendimin e eurodeputetëve sapa Komisioni Evropian të dalë me raportin pozitiv për vizat. "Jam i lumtur ta konfirmoj pohimin e presidentit të Parlamentit Evropian, se do ta

kemi përkrahjen e plotë të Parlamentit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët tanë. Ky është një lajm shumë i mirë. Ne po presim raportin pozitiv në fund të këtij muaji, në të njëjtën kohë pastaj në Parlamentin Evropian do ta marrim përkrahjen e nevojshme pro lëvizjes së lirë të qytetarëve tanë. Ky është një rrugëtim në disa hallka dhe ne po sensibilizojmë të gjithë aktorët në mënyrë që këtë vit qytetarët tanë të mund të lëvizin pa viza gjatë këtij viti", ka thënë kryeparlamentari Veseli pas takimit me presidentin e Parlamentit Evropian.

Kreu i Kuvendit të Kosovës e ka informuar kreun e Parlamentit Evropian për zhvillimet poli-

tike në Kosovë dhe për reformat e nevojshme që po ndërmerren institucionet e Kosovës në procesin e integriteteve evropiane. Veseli ka thënë se Kuvendi i Kosovës shqyrton me prioritet të veçantë dhe miraton të gjitha projektligjet që dalin në procesin e inte-

grimeve dhe ka komisionin e posaçëm që trajton përputhshmërinë e të gjitha ligjeve me ligjet e Bashkimit Evropian.

Veseli ka falënderuar Tajanin dhe Parlamentin Evropian në përgjithësi, për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë

shtetit të Kosovës dhe perspektivës evropiane të saj. Kreu i Kuvendit ka potencuar vendosmërinë e Kosovës për ta vazhduar rrugën e saj përpara në agjendën euroatlantike, si prioritet nacional, për të cilin ekziston konsensus i plotë midis subjekteve politike.

BDI-ja mbështet negociatat për zgjidhjen e emrit



SHKUP, 12 QERSHOR - Zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane i Maqedonisë, Bujar Osmani, ka informuar të martën anëtarët e Kryesisë së Bashkimit Demokratik për Integrim dhe liderin e kësaj partie Ali

Ahmeti për rrjedhën e negociatave për zgjidhjen e çështjes së emrit me Greqinë fqinje. Osmani pas takimit tha se BDI-ja u ka dhënë mbështetje negociatave që zhvillohen për zgjidhjen të këtij kontesti. "Informova anëtarët e krye-

sisë dhe liderin Ali Ahmeti për pozicionet dhe qëndrimin e harmonizuar të Qeverisë në negociatë, si dhe për sfidat kryesore të procesit. Kryesia e BDI-së mori vendim për mbështetje të tërësishme të negociatave dhe mbështetje

për qëndrimin e harmonizuar të Qeverisë. Nga këtu nisem drejt Qeverisë ku pres që kryeministri Zaev t'i kumtojë rezultatet përfundimtare nga negociatat", tha zëvendëskryeministri Osmani.

Meta uron PS-në për 27-vjetorin e themelimit

TIRANË, 12 QERSHOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka uruar të gjithë socialistët për 27-vjetorin e themelimit të Partisë

Socialiste. Kështu, kreu i shtetit nuk e ka kursyer një mesazh urimi për leadershipin, por edhe gjithë socialistët. "Në këtë përvjetor të theme-

limit të Partisë Socialiste, kësaj force politike shumë të rëndësishme, kam kënaqësinë t'i uroj leadershipit, anëtarëve dhe simpatizantëve të

saj, suksese për përmbushjen e përgjegjësive qeverisëse në funksion të së ardhmes evropiane të Shqipërisë", ka thënë Meta në urimin e tij.



Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka raportuar para Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Pacolli zotohet se do të ketë kuotë të barabartë në misionet diplomatike

Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka raportuar të martën para anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, për procesin e njohjeve, procesin e aplikimit në Këshillin e Evropës, për emërimet në shërbimin e jashtëm, si dhe për procesin e rotacionit. Ai ka thënë se reformimi i plotë i MPJ-së do të kryhet deri në fund të mandatit të tij si ministër, duke premtuar se stafi diplomatik do të jetë 50/50, gjysma e diplomatëve të emëruar politikisht, kurse gjysma tjetër e karrierës



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka raportuar të martën para anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike. Raporti i ministrit Pacolli kishte të bënte me procesin e njohjeve, procesin e aplikimit në Këshillin e Evropës, Procesin e Berlinit, për emërimet në shërbimin e jashtëm, si dhe për procesin e rotacionit.

Lidhur me këto çështje, ministri Pacolli vuri në dukje angazhimin e tyre dhe sfidat që janë duke hasur gjatë aktiviteteve diplomatike. Ai ka përmendur një mori takimesh me përfaqësues shtetesh dhe

qeverish të ndryshme, ndërkaq u shpreh optimist se rezultatet do të jenë të prekshme. Duke folur për sfidat në angazhimin e tyre, kryediplomati Pacolli ka bërë me dije se shteti serb është duke u përpjekur që shtetet të cilat e kanë njohur Kosovën, t'i bindë ta tërheqin njohjen. Për të arritur këtë qëllim Pacolli ka theksuar se Serbia është duke investuar mjete dhe asete të shumta shtetërore.

Pacolli është zotuar se nuk do të ndalet së lobuari për njohje të reja si dhe ka theksuar se Kosova do t'i ruajë njohjet që ka. "Ne kemi punuar shumë. Jemi duke harxhuar shumë kohë për ruajtjen e këtyre njohjeve që i kemi. Procesi i njohjeve është proces i vështirë. Shtetet që e kanë pasur ndërmend e kanë njohur

Kosovën, ndërsa këto shtetet e tjera janë pozicionuar në anën tjetër. Beogradi e ka synim tërheqjen e njohjeve nga vendet që na kanë njohur", ka thënë Pacolli.

Pacolli ka treguar se MPJ-ja është duke punuar në drejtimin që Ukraina do t'i pranojë pasaportat e Kosovës. Kjo, sipas tij, mund të ndodhë deri në fund të vitit.

Në vijim ministri Pacolli ka bërë me dije për gjendjen e shërbimit diplomatik në kuadër të min-

istrisë si dhe për ecurinë e emërimit të ambasadorëve. Lidhur me këtë, ai ka premtuar para komisionit se reformimi i plotë i MPJ-së do të kryhet deri në fund të mandatit të tij si ministër.

Po ashtu, ai ka pohuar se deri në fund të mandatit të tij stafi diplomatik do të jetë 50/50, gjysma e diplomatëve të emëruar politikisht, kurse gjysma tjetër e karrierës. "Do të mundohemi ta arrijmë kuotën 50/50. Mendoj se në fund mandatin

tim do ta dorëzoj me kuotën 50/50. Ju kam thënë se do të mundohemi t'arrijmë kuotën 50/50, që nënkupton se 50 % do të jenë të karrierës, 50 % të emëruar politikë", është shprehur Pacolli. Ai ka thënë se Kosova është duke u zhvilluar në aspektin diplomatik, megjithatë ka thënë se nuk ka mjaftueshëm ambasadorë të karrierës. Në këtë drejtim, Pacolli ka theksuar se është duke punuar me Akademinë Diplomatike në Gjermani.

Koha për kapitull të ri në marrëdhëniet e Kosovës me Kombet e Bashkuara

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Republika e Kosovës është mirënjohëse për rolin dhe kontributin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara gjatë procesit të shtetndërtimit të vendit tonë. Ky ka qenë një nga mesazhet kryesore të zëvendëskryeministrit të parë dhe ministrit të Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, gjatë takimit me ndihmëssekretaren e përgjithshme për operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara, Bintaoui Keita.

Në kuadër të këtij takimi kryediplomati i Kosovës ka kërkuar të ndryshohet formati i diskutimeve mbi Kosovën, respektivisht reduktim të seancave, pasi ato po abuzohen nga Serbia për ta penguar Kosovën si dhe të reduktohet buxheti i misionit të UNMIK-ut në Kosovë. "E di se nuk keni mundësi ta ndryshoni dinamikën në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të

Bashkuara, por formati i tanishëm i diskutimeve mbi Kosovën duhet ndryshuar. Seancat duhet të reduktohen nga 4 në 1 apo 2 në vit. Dëshira jonë është të mos ndodhin ato fare apo të mbaheshin në një debat të mbyllur për publikun. Diskutimi në Këshillin e Sigurimit të OKB-së po abuzohet nga Beogradi, duke dhënë një narrativë të ndryshme. Në Evropë Serbia synon ta promovojë veten si një lojtare konstruktive, ndërsa në OKB vazhdon politikën e saj të vjetër për ta penguar integrimin e Kosovës në bashkësinë ndërkombëtare dhe të paraqesë një imazh të rremë se Kosova është ende një zonë konflikti", ka thënë Pacolli, duke shtuar se do të ishte mirë që UNMIK-u ta zvogëlojë buxhetin, pasi nuk reflekton realitetin në terren. "Ne e kuptojmë se ky nuk është një vendim i marrë nga ju, por buxheti i UNMIK-ut nuk mund



të shpenzohet për çështje që lidhen me çështjet politike, sundimin e ligjit apo fusha të tjera

që mund të ndërhyjnë në kompetencën e Qeverisë", ka shtuar numri dy i Qeverisë. Pacolli ka

thënë se është koha për kapitull të ri në marrëdhëniet e Kosovës me Kombet e Bashkuara.

Flet për "Epokën e re", Ismet Salihu

Sistemi i drejtësisë ende nu



Profesori i së Drejtës Penale Ndërkombëtare, Ismet Salihu, ka thënë se ende sistemi i drejtësisë në vendin tonë nuk e ka arritur konceptin e pavarësisht për faktin se ende ka interferime dhe ndikime të politikës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se prania e EULEX-it edhe për dy vjetët e ardhshëm është një lloj mekanizmi që në një masë e mbron sistemin e drejtësisë prej interferimeve politike të njerëzve që janë në pushtet. Salihu ka pohuar se nëse Kosova nuk do të tregojë rezultate të mira në sistemin e drejtësisë, atëherë ka shumë gjasa që edhe pas dy vjetësh sërish EULEX-it t'i vazhdohet mandati. Ai ka thënë se edhe Gjykata Speciale është një ndër shkaqet dhe arsyet që ka ndikuar t'i vazhdohet mandati misionit të EULEX-it

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Profesori i së Drejtës Penale Ndërkombëtare, Ismet Salihu, ka thënë të martën se, pavarësisht prej të metave dhe dobësive, prania e mëtutjeshme e EULEX-it në Kosovë është e domosdoshme dhe e dobishme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se gjendja e gjithëmbarshme politike dhe ajo në sistemin e drejtësisë kanë ndikuar që këtij misioni t'i vazhdohet mandati edhe për dy vjet. "Prania e EULEX-it

është e dobishme për arsye se ende sistemi ynë i drejtësisë, duke u nisur prej organeve të ndjekjes, prokurorisë e gjykatave, ka nevojë për ndihmën e ndërkombëtarëve. Duke pasur parasysh situatën në Kosovë, është e domosdoshme prania e EULEX-it më së paku për dy vjetët e ardhshëm. Sistemi ynë i drejtësisë në përgjithësi, por edhe situata e gjithëmbarshme politike e bën të pranueshme praninë e EULEX-it me statusin e monitoruesit, mbështetësit dhe lehtësuesit në Kosovë", ka deklaruar Salihu.

Ai ka bërë me dije se ende

institucionet vendore të drejtësisë nuk e kanë arritur nivelin e duhur për ta funksionalizuar shtetin ligjor. Sipas Salihut, sistemi i drejtësisë nuk është i pavarur sepse në të ka interferime dhe ndikime nga politika. "Edhe sot e kësaj dite institucionet tona të drejtësisë nuk e kanë arritur nivelin e duhur për ta funksionalizuar shtetin ligjor. Megjithatë, vazhdimi i mandatit të EULEX-it nuk ka ndodhur vetëm për shkak të të metave të sistemit të drejtësisë, por është edhe për rrjedhojë të situatës së gjithëmbarshme politike në Kosovë. Ende sistemi i drejtësisë nuk ka

arritur konceptin e pavarësisht së duhur sepse ende ka interferime dhe ndikime të politikës. Kështu që, prania e EULEX-it në këtë aspekt është një lloj mekanizmi që në një masë e mbron sistemin e drejtësisë prej interferimeve politike të njerëzve që janë në pushtet", është shprehur ai, duke shtuar se, nëse vazhdohet me këtë situatë, këtij misioni mund t'i vazhdohet mandati edhe pas dy vjetësh. Në këtë kontekst, ai ka thënë se edhe Gjykata Speciale është një ndër arsyet që ka ndikuar t'i vazhdohet prania EULEX-it.

"Epoka e re": Profesor, si e keni parë vazhdimin e mandatit të EULEX-it edhe për dy vjet të tjera në shtetin e Kosovës?

Salihu: Unë kam pritur se këtij misioni do t'i vazhdohet mandati. Madje këtë e pata thënë edhe në një intervistë të mëhershme, po në gazetën tuaj. Asokohe pata deklaruar se edhe pas 15 qershorit EULEX-i do të jetë i pranishëm në Kosovë, por në një format tjetër. Më vjen mirë që doli

ashtu siç thashë, meqë Kosova ka nevojë për praninë ndërkombëtare edhe më tutje duke pasur parasysh situatën në sistemin tonë të drejtësisë si dhe situatën politike në përgjithësi. Sipas mendimit tim, prania e mëtutjeshme e EULEX-it është e domosdoshme dhe e dobishme për Kosovën dhe qytetarët e saj.

"Epoka e re": Pse është e dobishme prania ndërkombëtare 19 vjet pas çlirimit dhe 10 vjet pas pavarësisht tonë?

Salihu: Prania e EULEX-it është e dobishme për arsye se ende sistemi ynë i drejtësisë, duke nisur prej organeve të ndjekjes, prokurorisë e gjykatave, ka nevojë për ndihmën e ndërkombëtarëve. Duke pasur parasysh situatën në Kosovë, është e domosdoshme prania e EULEX-it më së paku për këta dy vjetët e ardhshëm. Sistemi ynë i drejtësisë në përgjithësi, por edhe situata e gjithëmbarshme politike, e bën të pranueshme praninë e EULEX-it me statusin e monitoruesit, mbështetësit dhe lehtësuesit

k ka arritur të pavarësohet



në Kosovë.

"Epoka e re": Vazhdimi i mandatit të këtij misioni tregon se institucionet vendore të drejtësisë ende nuk janë të përgatitura sa duhet dhe të pavarura për të vendosur rend dhe ligj në Kosovë?

Salihu: Edhe sot e kësaj dite institucionet tona të drejtësisë nuk e kanë arritur nivelin e duhur për ta funksionalizuar shtetin ligjor. Megjithatë, vazhdimi i mandatit të EULEX-it nuk ka ndodhur vetëm për shkak të metave të sistemit të drejtësisë, por është rrjedhojë edhe e situatës së gjithëmbarshme politike në Kosovë. Ende sistemi i drejtësisë nuk ka arritur konceptin e pavarësisë së duhur sepse ende ka interferime dhe ndikime të politikës. Kështu që, prania e EULEX-it në këtë aspekt është një lloj mekanizmi që në një masë e mbron sistemin e drejtësisë prej interferimeve politike të njerëzve që janë në pushtet. Edhe kjo është një prej shkaqeve që e arsyeton praninë ndërkombëtare në sistemin tonë të drejtësisë.

"Epoka e re": Si mund të pritet një rol pozitiv nga ky mision brenda të cilit ka pasur skandale për keqpërdorim dhe korrupsion?

Salihu: Ka pasur skandale, ka

pasur defekte, ka pasur dobësi si dhe korrupsion, por nëse i peshojmë të metat dhe të mirat e EULEX-it në Kosovë në këta dhjetë vjet, prapë të mirat peshojnë me shumë sesa të metat. Posaçërisht në luftimin e korrupsionit. Korrupsioni nuk luftohet vetëm me deklarata dhe me hartimin e ligjeve, por me zbatimin e ligjit pavarësisht kush është dhe çfarë pozite ka. Unë e përdori shpeshherë këtë maksimum, se ligjet janë të mira aq sa janë njerëzit e mirë duhet t'i zbatojnë, por njerëzit e mirë janë aq të mirë sa u mundësohet zbatimi i ligjeve.

"Epoka e re": Z. Salihu, meqë po thoni se së paku edhe dy vjet do të jetë EULEX-i në Kosovë, ka gjasa që sërish këtij misioni t'i vazhdohet mandati?

Salihu: Nëse vazhdohet me këtë situatë, ka shumë gjasa që pas dy vjetësh sërish EULEX-it t'i vazhdohet mandati. Dhe unë jam ihtar i asaj që t'i vazhdohet mandati këtij misioni për shkak të këtij mjedisi të pasigurt politik.

"Epoka e re": Është i ndërlidhur me Gjykatën Speciale vazhdimi i mandatit të EULEX-it?

Salihu: Po. Siç e dini, në Ligjin për Gjykatën Speciale thuhet se vendimet dhe urdhrat e

Gjykatës Speciale do t'i ekzekutojë Policia e Kosovës, në rast nevojë do të angazhohet edhe policia e EULEX-it, madje në rast nevojë do të angazhohet edhe KFOR-i. Në këtë drejtim asgjë nuk i është lënë rastit. Kështu që, edhe Gjykata Speciale është një ndër shkaqet dhe arsytet që ka ndikuar t'i vazhdohet mandati misionit të EULEX-it.

"Epoka e re": Por përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës në vazhdimësi kanë deklaruar se pas 15 qershorit EULEX-i do të jetë i panevojshëm.

Salihu: Është në natyrën e politikanëve të thonë gjëra të tilla për ta promovuar punën e tyre. Ata japin deklarata politike, kurse unë jap deklarata profesionale dhe juridike si profesor i drejtësisë dhe si specialist i së drejtës penale ndërkombëtare. Politikanëve çdo deklaratë u lejohet dhe u mirëkuptohet, kurse ekspertëve të fushës jo. Si mos të jetë i nevojshëm EULEX-i kur 19 vjet pas çlirimit të Kosovës asnjë person i nivelit të lartë nuk është dënuar për korrupsion. Janë nisur hetimet, janë bërë akuzat, por vendime nuk ka pasur. Megjithatë, një gjë është e qartë, si e kanë bërë gjithë këtë pasuri politikanët tanë.

Haradinaj: Nga rritja e pagave më së shumti fitojnë gjyqtarët dhe prokurorët

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Qeveria e Kosovës ka shfuqizuar vendimin e mëhershëm për pezullim të vendimit për ngritjen e pagave të zyrtarëve shtetërorë. I pari i Qeverisë, Ramush Haradinaj, ka thënë se në pajtim me akt-gjykimin e Gjykatës Kushtetuese shfuqizohet vendimi i 1 shkurtit që parashihet pezullimin e vendimit të Qeverisë për rritjen e pagave. "Vendimi ynë është pezulluar për shkak të respektimit të procedurave ligjore dhe të procesit të hapur në Kushtetuese. Pasi vendimi i Kushtetueses tani është fuqplotë, vetëkuptohet se vjen shfuqizimi i pezullimit, pasi kemi marrë masë të pezullimit. Nuk ka qenë anulim, ka qenë pezullim. Këtë e kemi bërë sot. Tani këto procedurat i zbaton Qeveria", ka thënë Haradinaj. Kryeministri Haradinaj ka thënë se nga kjo rritje e pagave më së shumti përfitojnë gjyqtarët dhe

prokurorët. "A e dini sa i vogël është numri i pushtetarëve që përfitojnë nga rritja e pagave? Këtu përfitojnë 600 gjyqtarë dhe prokurorë. Pra, mos harroni, sot fitues janë ata. Edhe ne po flasim për rend dhe ligj, po hartojmë ligje të mira. Sot u ka shkuar përkrahja më e fuqishme institucioneve të zbatimit të ligjit. Në këtë rast, nga sot 600 gjyqtarë dhe prokurorë i kanë pagat me ngritje", ka thënë kryeministri Haradinaj pas mbledhjes së Qeverisë.

Ai ka folur edhe për reagimin e BSPK-së, e cila ka kërkuar rritjen e pagave edhe për pjesën tjetër të punëtorëve, duke thënë se rritja e pagave është nivelizim i pagave të zyrtarëve të shtetit. Kryeministri Haradinaj ka thënë se pagat me rritje zyrtarët e shtetit do t'i marrin që nga koha kur është marrë vendimi për rritje të pagave.



Hariz Roka (Reuters)

Kosova nderon ushtarët e rënë të KFOR-it me memorial në qendër të Prishtinës

"Ky memorial është një simbol që Kosova ka vendosur për rrugën e vet në nderimin ndaj të rënëve. Liria është vlera jonë e përbashkët: e Kosovës dhe e aleatëve", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në ceremoninë e zbulimit të pllakës memoriale të ushtarëve të KFOR-it, të rënë gjatë shërbimit në Kosovë



tenti i sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, John Manza, ka thënë se KFOR-i vazhdon të jetë i suksesshëm për krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt për lirinë e lëvizjes, për të gjithë ata që jetojnë në Kosovë. "Ky monument do të mbetet një simbol për një kohë të gjatë për atë se çfarë kemi bërë gjatë këtyre viteve në Kosovë dhe të ndërtojmë një Kosovë të fortë, që synon

drejt së ardhmes, e cila është integrimi euroatlantik", ka thënë Manza. Në emër të sekretarit të përgjithshëm të NATO-s ai ka falënderuar popullin e Kosovës për këtë iniciativë për ngritjen e këtij monumenti në qendër të Prishtinës.

Në ceremoninë e zbulimit të pllakës memoriale të ushtarëve të KFOR-it morën pjesë edhe ministri i Forcës së Sigurisë së

Kosovës, Rustem Berisha, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Rahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Salvatore Cuoci, drejtori i NALT-it, gjeneral Ralf Hofman, ambasadorë të akredituar në Kosovë, atashe të Mbrojtjes dhe familjarë të ushtarëve të NATO-s dhe të KFOR-it, që kanë humbur jetën në Kosovë.

organizatën e ushtrimit të paqes, për të ndihmuar jo vetëm vetën dhe rajonin, por kudo dhe këdo që ka nevojë.

Kryeministri Haradinaj ka theksuar gatishmërinë e Kosovës për të kontribuar për sigurinë dhe paqen në botë, duke mirëpritur qëndrimin e NATO-s në Kosovë. "Ky memorial është një simbol që Kosova ka vendosur për rrugën e vet në nderimin ndaj të rënëve. Liria është vlera jonë e përbashkët: e Kosovës dhe e aleatëve", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha, tha se NATO që udhëhoqi operacionin për mbështetjen e paqes në Kosovë, operacion ky që ktheu shpresën për liri dhe siguri, do të mbetet përjetësisht në historinë më të re të Kosovës si dita e kthimit të shpresës.

Ndërkaq zëvendësndihmësis-

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të martën në ceremoninë e zbulimit të pllakës memoriale të ushtarëve të KFOR-it, të rënë gjatë shërbimit në Kosovë. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se në këtë ditë të paqes kujtojmë dhe nderojmë burrat dhe gratë, ushtarët e NATO-s dhe të KFOR-it, që sakrifkuan jetën e tyre në shërbim të paqes dhe sigurisë në Kosovë. "Qeveria dhe populli i Kosovës u është përjetë mirënjohës NATO-s dhe shteteve që kontribuojnë në KFOR. Ne jemi popull që shprehim falënderim, nuk harrojmë të kaluarën dhe duam të kemi një të ardhme të sigurt", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se Kosova synon anëtarësimin në NATO, në

Ministri Bytyçi thotë se testi i maturës ka qenë i suksesshëm

EPOKA E RE **Arbsia SHEFKIU**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyçi, ka raportuar të martën para anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Arsim, në të cilën është folur për organizimin e testit të Maturës Shtetërore 2018 si dhe tema të tjera me rëndësi. Ministri Bytyçi i ka njoftuar anëtarët e Komisionit Parlamentar për ecuritë dhe administrimin e testit të maturës, me ç'rast ka theksuar se menaxhimi i këtij testi, të organizuar për herë të parë në katër regjione, e ka lehtësuar punën dhe ka pamundësuar parregullsitë në masë të konsiderueshme. "Mendoj se është arritur qëllimi primar i ndarjes në katër regjione të mbajtjes së testit të maturës, i cili kishte për synim të menaxhohet më mirë dhe dukuritë negative që kanë ndodhur në të kaluarën të mos na përsëriten", ka thënë ministri Bytyçi. Ai ka shtuar se MASHT-i, duke filluar nga Divizioni për Standarde dhe Vlerësim, ka bërë përgatitjet e duhura në bashkëpunim edhe me DKA-të dhe kjo ka dhënë

rezultat të mirë, ndërsa mbajtja e testit në katër regjione ka bërë që testi sivjet të jetë më mirë se çdoherë tjetër. "Nëse do të bënim një përkufizim të përgjithshëm, them se rezultatet e testit të maturës do ta kenë një përqindje më të lartë të realitetit, apo besueshmërisë sesa ka qenë në vitet e kaluara", ka thënë ministri Bytyçi.

Ministri Bytyçi ka thënë se këtë vit testit i janë nënshtruar 27 737 nxënës, ndërsa për shkak të parregullsive janë përjashtuar 56 nxënës dhe 8 administratorë, ndërsa nxënësit e përjashtuar do të kenë të drejtë testimi në afatin e dytë.

Deputeti i PDK-së, Nezir Çoçaj, ka kërkuar që në të ardhmen të kalohet në maturën digjitale pasi, sipas tij, do të parandalohet kopjimi dhe rezultatet do të ishin më reale. Ndërsa udhëheqësi i Divizionit për Vlerësim dhe Monitorim në Ministrinë e Arsimit, Mustafë Kadriu, ka thënë se në pjesën e dytë të testit do të bëhen disa ndryshime. "Jemi duke punuar që të ndryshojmë diçka në brendësi të tekstit, që i përshtatet më mirë drejtimeve dhe nxënësve", ka thënë ai.



Në këtë mbledhje të këtij komisioni është folur rreth organizimit të tryezës së rumbullakët me Komisionin Parlamentar për Arsim, të iniciuar nga GIZ-i si prijëse e fushatës "Për një arsim më

të mirë në Kosovë", të lansuar në nëntor të vitit të kaluar, në të cilën tryezë do të ftohen edhe ministri i Financave, kryetari i Komisionit Parlamentar për Financa dhe donatorët përkrahës të fushatës.

Tryeza e rumbullakët do të mbahet javën që vjen dhe ka për qëllim ta nxisë avokimin e deputetëve për ta bërë arsimin prioritet edhe në aspektin buxhetor.

Apostolova kërkon angazhim më të shtuar në zbatimin e MSA-së



Shefja e misionit të Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalia Apostolova, i është adresuar të martën kabinetit qeveritar sa i përket zbatimit të reformave evropiane ERA 2017. Ajo ka bërë me dije se në shtator të këtij viti komisionari për Zgjerim dhe Politikë e Fqinjësisë, Johannes Han, do ta vizitojë Kosovën dhe do të shikojë se çfarë është arritur nga ERA 2017. Ajo ka thënë se Kosova e ka rastin të tregohet një partnere e besueshme e BE-së në zbatimin e zotimeve që ka marrë në raport me agjendën evropiane

**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Me kërkesë të kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, shefja e Zyrës së BE-së në Kosovë, Natalia Apostolova, i është adresuar të martën kabinetit qeveritar në mbledhjen e 51-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në fillim të fjalës së tij, kryeministri Haradinaj ka thënë se Qeveria e ka bërë një agjendë të trashëguar të reformave evropiane ERA 2017, një pjesë e të cilave prioritet janë realizuar, siç janë ato në rend dhe ligj, luftën antikorruption, në reformat e administratës shtetërore, në përmirësimin e klimës biznesore, sigurimin e stabilitetit energjetik dhe tema të tjera dhe se mbeten ende disa

tema të hapura. "Ju siguroj një gjë, se unë dhe secili prej nesh vërtet kemi interesim për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Kemi interesim t'i vazhdojmë reformat evropiane. Kosova është e përcaktuar për perspektivën evropiane", ka thënë Haradinaj. Ndërkaq shefja e misionit të BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, ka thënë se si përfaqësuese speciale e BE-së, roli i saj është ta mbështesë Qeverinë në punën dhe në tentativat për anëtarësim në familjen evropiane, por edhe t'i adresojë disa nga sfidat që e presin. "Sa i përket afateve kohore dhe veprimeve, ju duhet t'i realizoni në mënyrë që në fund të këtij viti të kemi një storie të suksesit të zbatimit të ERA-s. Nëse e keni lexuar me kujdes Strategjinë për Ballkanin

Perëndimor, dokumenti i publikuar para disa muajsh nga Komisioni dhe të cilin e konsiderojmë dokumentin më të rëndësishëm dhe më të guximshëm për të gjithë partnerët e Ballkanit Perëndimor, mund ta keni lexuar që anëtarësimi i Kosovës dhe rrugëtimi drejt BE-së shkon në rrafshin e zbatimit të MSA-së", ka thënë Apostolova, duke shtuar se Agjenda e Reformave Evropiane është një ushtrim i përbashkët mes nesh, Komisionit Evropian, Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Kosovës. "Këto prioritet kanë afate kohore dhe këto afate kohore për t'u zbatuar kanë pasur një vit. Ne e dimë shumë mirë se pse brenda këtij viti pjesa më e madhe e këtyre veprimeve nuk kanë mundur të zbatohen dhe për këtë Komisioni ka vendosur të vazhdojë apo zgjasë për 7 apo 8 muaj të zbatimit të ERA-s të 2017-s. Për momentin jemi në 2018-n, kështu që cili tani është realiteti", ka thënë Apostolova në fjalën e saj drejtuar kabinetit qeveritar, duke theksuar se në shtator të këtij viti komisionari për Zgjerim dhe Politikë e Fqinjësisë, Johannes Han, do të vizitojë Kosovën dhe do të shikojë se çfarë është arritur nga ERA 2017, pastaj të fillohen negociatat për fazën e re të ERA-s e cila do të jetë ERA 2019. "Ju si qeveri e keni rastin të realizoni sa

më shumë që është e mundur nga prioritetet të cilat bien në sektorin tuaj të veprimit para shtatorit të 2018-s dhe është rasti që Kosova të tregohet partnere e vërtetë dhe e besueshme që i zbaton zotimet të cilat i ka ndërmarrë para disa kohësh", ka përfunduar adresimin e saj Apostolova.

Në këtë mbledhje kanë qenë edhe ministrat e kabinetit qeveritar që kanë adresuar çështjet të cilat janë në kompetenca të ministrave që ata drejtojnë për përafrimin e vendit me Agjendën Evropiane.

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka paraqitur gjendjen e zbatimit të Programit Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA), gjatë tremujorit të parë të këtij viti, bazuar në raportin e hartuar nga Ministria e Integritimit, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse. "Për këtë vit ky program ka paraparë zbatimin e 531 masave afatshkurtra, prej të cilave 144, ose rreth 27 % e tyre janë masa legislative, ndërsa pjesa tjetër prej 387 masave, ose rreth 73 % e tyre janë masa zbatuese", ka theksuar ministrja Hoxha, duke shtuar se gjatë tremujorit të parë është arritur një shkallë e përgjithshme e zbatimit të programit prej 53.85%.? Ministrja Hoxha ka theksuar se 21 nga 39 masat e planifikuara për

këtë tremujor janë zbatuar, ndërsa pjesa e mbetur prej 18 masave, ose 46.15 %, akoma nuk kanë arritur të zbatohen. Përveç këtyre, ministrja ka potencuar se 23 masa janë zbatuar para afateve të planifikuara. Sipas saj, deri në fund të tremujorit të parë janë zbatuar gjithsej 44 masa, të cilat përbëjnë 8.29 % nga 531 masa të planifikuara.

Sa i përket zbatimit të reformave legislative, ministrja Hoxha ka thënë se të gjeturat tregojnë se është arritur një shkallë zbatimi prej 13.89 %, pasi që janë zbatuar 20 nga 144 masat afatshkurtra legislative të planifikuara për tërë vitin, ndërsa 124 prej tyre, pra 86.11 %, ende nuk kanë arritur të zbatohen. "Deri në fund të marsit drejt zbatimit të masave, të gjeturat tregojnë se është arritur një shkallë zbatimi prej 6.20 %, pasi që është arritur të zbatohen 24 nga 387 masat afatshkurtra të planifikuara, ndërsa 363 prej tyre, ose 93.8 %, ende nuk kanë arritur të zbatohen", ka thënë ministrja Hoxha. Ajo ka shtuar se gjatë këtij tremujori Ministria e Integritimit ka organizuar takime të rregullta të komisioneve ekzekutive për integrim evropian dhe të Komitetit Punues për Integrim Evropian, me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve përgjegjëse, për ta siguruar zbatimin e plotë dhe në kohë të masave të parapara në kuadër të programit të MSA-së.

Posta kërkon nga deputetët të mos e votojnë nenin 11 dhe 62 të draftligjit për shërbimin postar

EPOKA E RE**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Menaxhmenti i Postës së Kosovës u ka bërë thirrje publike deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të përfshihen në komentet dhe rekomandimet e propozuara të Postës së Kosovës në Ligjin për Shërbimin Postar, i cili është në procedurë të leximit të dytë. "Menaxhmenti i Postës së Kosovës kërkon vëmendjen e opinionit publik, si dhe vigjilencën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, se Ligji për Shërbimin Postar, i cili është në procedurë të leximit të dytë, është jetik për funksionimin e mirëfilltë të Postës së Kosovës. Me shqetësim dhe përgjegjësi të lartë kërkojmë nga ju, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, që të përfshihen në

komentet dhe rekomandimet e propozuara të Postës së Kosovës të dërguara me shkrim grupit punues të MZHE-së dhe Kuvendit të Kosovës, Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Infrastrukturë, veçanërisht lidhur me: Neni 11 dhe 62 të draftligjit janë me përmbajtje shkatërrimtare për tregun e shërbimit postar në Kosovë, në veçanti Operatorin Publik Postar - Postën e Kosovës. Prandaj, kërkojmë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, që të mos votohen këto nene si të tilla, por të formulohen sipas praktikave dhe ligjeve të shteteve në rajon", është theksuar në thirrjen e menaxhmentit të Postës së Kosovës. Ky menaxhment ka treguar edhe për pasojat që ka neni 11. "Legalizimi i operimit të një operatori të dytë publik, që nuk

ndodh në asnjë shtet të rajonit apo mundësia e legalizimit të operimeve të deritashme ilegale të postës serbe në Republikën e Kosovës, e cila tash e 18 vjet operon në formën ilegale, duke i marrë ilegalisht rreth 30 % të tregut të Postës së Kosovës. Kurse pasojat e nenit 62 janë: tentativa e MZHE-së që përmes Ligjit të ri ta shfuqizojë marrëveshjen me numër protokollit 263 të datës 6. 2. 2014, që e ka Posta me MZHE-në, e që kjo marrëveshje ka bazën ligjore në ligjin ekzistues. Kjo marrëveshje është ligjore dhe e nënshkruar me paramendim nga të dyja palët, që nuk u zbatua asnjëherë nga Ministria. Tentativa për ta shfuqizuar këtë marrëveshje me ligjin e ri me efekt retroaktiv është joligjore dhe me efekt të shmangies së përgjegjësisë dhe obligimeve financiare që MZHE-



ja ka ndaj Postës së Kosovës. Për këto obligime ka urdhër përmbardimor dhe vendime të gjykatës. Me qëllim të evitimit të pasojave të pakrahasueshme të këtyre dy neneve të përshkruara më lart, u bëjmë thirrje publike të gjithë deputetëve të Kuvendit

të Republikës së Kosovës, që të mos i votojnë këto nene të draftligjit, të cilat janë goditja e fundit për shkatërrimin e Operatorit Publik Postar - Postës së Kosovës", është thënë në thirrjen e menaxhmentit të Postës së Kosovës.

Gashi: Askush nuk mund t'i pengojë investitorët në Kosovë



PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka pritur të martën në takim një delegacion të Korporatës Financiare Ndërkombëtare (ICF), i cili përbëhet nga Fuphan Chou, Tjomas Lubeck dhe Gaetan

Tiberghien. ICF-ja është pjesë e grupit të Bankës Botërore, e fokusuar në investime. Zëvendëskryeministri Gashi e ka informuar delegacionin për procesin e investimeve strategjike, sektorët strategjikë, në veçanti për rëndësinë që ka ligji dhe qasjen e lehtë që u

mundëson kompanive serioze ndërkombëtare për investim në Kosovë. Po ashtu, Gashi i ka siguruar të pranishmit se Ministria e Diasporës dhe e Investimeve Strategjike do të jetë afër investitorëve potencialë strategjikë për t'u ndihmuar me të dhënat dhe informatat e duhura gjatë procesit

të aplikimit për statusin e investitorit strategjik. Ndër të tjera, Gashi u ka thënë të pranishmëve se askush nuk mund t'i pengojë investitorët seriozë në Kosovë. Ai ka theksuar se roli i ministrisë që drejton është t'i mbrojë dhe t'i ndihmojë ata në gjithë procesin.

Përfaqësuesit e Korporatës Financiare Ndërkombëtare (ICF) kanë shprehur interesim për procesin e investimeve strategjike, procedurat e shkurtuara, formën e aplikimit, në veçanti ata u interesuan për investimet në sektorin e energjisë dhe në atë të turizmit.

Kosova përfiton 10 milionë euro nga KE-ja për efikasitetin e energjisë



EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Projektligji për efikasitetin e energjisë është hartuar duke marrë për bazë të gjitha standardet e Bashkimit Evropian (BE) në fushën e efikasitetit të energjisë dhe sjellë një numër të konsiderueshëm të risive krahasuar me legjislacionin që ka qenë në fuqi deri më tani. Kështu ka deklaruar të martën ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluca, gjatë paraqitjes së ekspozesë për këtë projektligj para Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik,

Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal.

Lluca ka thënë se projektligji vendos synimet e Republikës së Kosovës në përputhje me kërkesat e BE-së sa i përket efikasitetit të energjisë, përcakton strukturën dhe përmbajtjen e Planit kombëtar të veprimit për efikasitetin e energjisë dhe planeve komunale të veprimit për efikasitetin e energjisë si dokumente kryesore strategjike; përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Kosovës për efikasitetin si dhe politikave dhe objektivave të tjera nacionale. Gjithashtu, ministri Lluca ka

nënvizuar se ky projektligj themelon Fondin e Kosovës për efikasitetin e energjisë, i cili do të shërbejë si një mekanizëm i qendrueshëm, që do të ndihmojë në arritjen e caqeve të Republikës së Kosovës në fushën e Efikasitetit të Energjisë. Ai ka thënë se ky fond do të investojë në projekte të efikasitetit, kryesisht në sektorin publik ku, sipas tij, do të synohet që investimet të kthehen përmes kursimit të energjisë. "Dëshiroj të potencoj se ky projektligj është hartuar me ndihmën e Projektit të Mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe janë konsultuar të gjitha

palët e interesit. Përveç kësaj, teksti i projektligjit është konsultuar edhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe janë marrë për bazë vërejtjet dhe sugjerimet e ekspertëve ndërkombëtarë të kësaj fushe", ka thënë Lluca. Sipas ministrit Lluca, Kosova do të përfitojë rreth 10 milionë euro nga Komisioni Evropian (KE) në formë granti me hyrjen në fuqi të këtij projektligji. Ai ka thënë këto mjete do të implementohen nga Fondi i Kosovës për efikasitetin e energjisë. Po ashtu, ai ka thënë se pjesë e rëndësishme e financimit të projekteve të efikasitetit

përmes këtij fondi do të jetë edhe Banka Botërore, kontributi i tyre fillestar parashihet të jetë diku pesë milionë dollarë.

Duke vlerësuar projektligjin si mjaft të avancuar, konform standardeve të BE-së në fushën e efikasitetit të energjisë, ministri Lluca ka kërkuar nga anëtarët e komisionit parlamentar të votojnë për miratimin e këtij projektligji. Në këtë kontekst, Lluca ka thënë se MZHE-ja do të jetë e gatshme që në fazat e mëtejme të punojë me Komisionin Evropian për ta shqyrtuar dhe plotësuar këtë projektligj gjatë trajtimit në Kuvendin e Kosovës.

Guvernatori Mehmeti ndan çmimet 'Ekonomisti i Ri'

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Në funksion të zhvillimit të hulumtimit ekonomik, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka ndarë çmimin për hulumtuesit më të mirë të paraqitur nga ekonomistët e rinj, në fushën e sistemit financiar dhe zhvillimit ekonomik në vend. Të martën në ambientet e BQK-së, guvernatori i kësaj banke, Fehmi Mehmeti, ka ndarë çmimet për punimet fituese të paraqitura për çmimin "Ekonomisti i Ri për vitin 2017".

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të punimeve më të mira hulumtuese në fushën e ekonomisë dhe financave, Komisioni profesional ka vlerësuar hulumtimin me titull: "Portfolio risk of international diversification of Kosovo Pension Fund: a historical perspective" punuar nga Florin Aliu dhe punimin e Arian Krasniqit me titull: "Plasimi i produkteve të Kosovës në tregun e Bashkimit Evropian: Aplikimi i strategjive diferencuese si faktor signifikant".

Guvernatori i BQK-së, Fehmi

Mehmeti, ka thënë se është i kënaqur me përzgjedhjen e fituesve të çmimit 'Ekonomisti i Ri'. "Nuk mund të ketë zhvillim ekonomik pa pasur zhvillim të stabilitetit financiar dhe ky është një nga qëllimet e mia kryesore prej që jam emëruar në pozitën e guvernatorit. Andaj qëllimi ynë kryesor është që fillimisht ta kemi stabilitetin financiar ku aktualisht jemi më së miri në rajon", ka thënë ai.

Mehmeti ka pohuar se planifikojnë t'i zgjerojnë funksionet e BQK-së në funksion të përkrahjes së ekonomisë. Ai ka treguar se janë duke krijuar edhe një qendër të përditësimit të transaksioneve të kartelave në Kosovë. "Krejt këto po bëhen me qëllim të rritjes së funksioneve të Bankës Qendrore të Kosovës", është shprehur Mehmeti.

Ndërsa fituesit e çmimeve kanë falënderuar guvernatorin Mehmeti për përkrahjen e nis-mave të tilla nga BQK-ja që, sipas tyre, janë në dobi të hulumtuesve të rinj.



Mbyllet një bastore sportive në Malishevë

MALISHEVË, 12 QERSHOR (ER) - Drejtoria e Inspektoratit në Komunën e Malishevës ka mbyllur një lokal afarist, përkatësisht një bastore sportive, e cila nuk ka respektuar ligjin duke zhvilluar aktivitetin në largësi më pak se 500 metra nga institucionet publike. Drejtori i Inspektoratit, Dibran Kastrati,

ka bërë me dije se ky lokal kishte shpërfillur paralamërimin e inspektorëve për mbyllje të kësaj veprimtarie. "Kjo bastore nuk i plotëson kushtet në bazë të ligjit, pasi gjendet më afër se 500 metra nga institucionet publike. Prandaj kemi marrë aksionin për mbylljen e lokalit", ka thënë Kastrati.



Në Gjilan hapet Konsullata e Nderit e Shqipërisë

GJILAN, 12 QERSHOR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Bajram Hasani, së bashku me ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi dhe kryetarin e Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, kanë hapur të martën në Gjilan Konsullatën e Nderit të Republikës së Shqipërisë. Hasani ka thënë se hapja e kësaj konsullate është një

tregues shumë i mirë për thellimin e bashkëpunimit mes qytetit të Gjilanit dhe Shqipërisë. "Në radhë të parë në forcimin e lidhjeve shpirtërore, por edhe nxitjen e bashkëpunimeve në fusha të tjera, përfshirë këtu ekonominë, arsimin, kulturën e të tjera. Ky është edhe një detyrim për t'i zhvilluar edhe më tej marrëdhëniet tona", ka thënë

Hasani. Ministri Bajrami i ka uruar punë të mbarë konsullit Valon Ademi. Hapja e Konsullatës së Nderit të Shqipërisë në Gjilan është bërë në 19-vjetorin e shënimit të Ditës së Çlirimit. I pranishëm në këtë ngjarje ishte edhe këshilltari i lartë i zëvendëskryeministrit Fatmir Limaj, Endrit Shala.



Mitrovica ndërmerr masa për sigurinë e qytetarëve gjatë sezonit veror

MITROVICË, 12 QERSHOR (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) në Komunën e Mitrovicës ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin është diskutuar lidhur me sensibilizimin për rrezikshmërinë gjatë qëndrimit në liqenin artificial dhe për përgatitjet e sezonit veror dhe masat mbrojtëse nga zjarri. Në këtë takim ishin të pranishëm përfaqësues të inspeksionit komunal, Policisë së Kosovës, FSK-së, zjarrfikësve, institucioneve të tjera dhe OJQ-ve. Pjesëmarrësit në takim vlerësuan njëzëri se liqeni artificial në

Suhadoll ofron mundësi të jashtëzakonshme për pushim e rekreacion të qytetarëve. Mirëpo, të pranishmit në takim vlerësuan se uji i akumuluar në liqe paraqet rrezik për qytetarët që duan të shfrytëzojnë atë për larje për shkak se është i ftohtë dhe për shkak të thellësisë që arrin deri në tri metra. Përveç kësaj, anëtarët e KKS-së folën edhe për sigurinë në trafik, duke vlerësuar se tani gjatë sezonit veror qarkullimi i automjeteve shtohet dukshëm edhe për faktin se bashkatdhetarët tanë që jetojnë jashtë vendit vijnë për

pushime. Lidhur me këtë anëtarët e KKS-së kërkuar nga institucionet komunale dhe Policia e Kosovës që t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të pasur rend në trafik dhe për t'i evituar rreziqet për këmbësorë dhe pjesëmarrës në komunikacion. Ndërsa nga qytetarët u kërkuar të jenë të kujdesshëm dhe t'i respektojnë shenjat e komunikacionit dhe ligjin, si dhe të shfrytëzojnë për parkim të automjeteve vetëm hapësirat e dedikuara për këtë, që tani ka mjaft në qytetin e Mitrovicës.

Banorët e Vitisë nga mesi i shtatorit pritet të kyçen në autoudhën 'Arbën Xhaferi'



Viti, 12 qershor (ER) - Ministri i Infrastruktura, Pal Lekaj, ka pritur të martën në takim një delegacion të qytetarëve e përfaqësuesve të Komunës së Vitisë, në përbërje të personaliteteve politike nga niveli qendror i kësaj ane, shoqërisë civile dhe medieve, të kryesuar nga kryetari Sokol Haliti. Lekaj i ka siguruar qytetarët e Vitisë se kërkesa e tyre për qasje në Autoudhën R6 "Arbën Xhaferi", Prishtinë - Hani i Elezit, do të realizohet

dhe se implementimi i këtij projekti do të fillojë nga mesi i shtatorit të këtij viti. Kryetari i Vitisë, Sokol Haliti, duke folur në emër të institucioneve lokale të Vitisë, ka falënderuar Lekajn për gatishmërinë e treguar që të trajtojë drejt dhe saktë kërkesën e banorëve të komunës së tij për kyçjen që do të bëhet në Gërllicë, e cila e lidhë tërë këtë pjesë të rajonit dhe jo vetëm Vitinë me Prishtinën dhe Shkupin.

Fshati Kçiq i Mitrovicës bëhet me rrjet të ri elektrik

Mitrovicë, 12 qershor (ER) - Investimet e radhës nga Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike KEDS kanë zbritur edhe në një rajon të

rëndësishëm të Mitrovicës, përkatësisht në Kçiq. Investimet e KEDS-it të shtrirë në fshatin Kçiq të Madh po ndikojnë drejtpërdrejt në furnizimin kualitativ dhe sta-

bil me energji elektrike. Zëdhënësi i KEDS-it, Viktor Buzhala, ka thënë se edhe në Kçiq të Mitrovicës, si dhe në çdo vend tjetër në Kosovë KEDS-i po rregullon rrjetin

elektrik. "Ne jemi të lumtur që 269 familje të këtij fshati kanë energji elektrike më kualitative dhe më të sigurt. Ky është një tregues që KEDS-i është i vendosur ta rregullojë rrjetin

elektrik në tërë territorin e vendit, me prioritet aty ku gjendja është më e rëndë dhe ku numri i konsumatorëve është më i madh", ka thënë Buzhala.

MOS VDEKSHA SA TË JENË NË PUSHTET HASHIMI DHE BEHGJETI!



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Duhet të vdesësh që të vlerësojnë: Ditë më parë ndërroi jetë, sigurisht deri më tani, futbollisti më i mirë shqiptar jo vetëm në Kosovë, por në të gjitha trojet ku kanë jetuar dhe ku kanë luajtur futboll, Fadil Vokrri. Fadili rrjedh nga një familje 100 % futbollistike, babai Abdullahu ka luajtur në Klubin e Futbollit Llapi sikur edhe xhaxhallarët, Selatini dhe Muhameti, kurse vëllai më i vogël gjithashtu ka qenë futbollist i talentuar. Podujeva e Agim Veliut dhe Besiana e Adem Demaçit ka pasur futbollistë të shquar si Shaban Hajrullahu, Emin Simnica, Esat Mehmeti, Emin Ajvazi, Ibrahim dhe Ruzhdi Demiri, Fazli Llugaliu apo Xhorxh Besti llapjan, Ragip Çitaku i cili ka qenë i paparë kur e ka pasur topin në këmbë, muçollët gjithashtu dhe shumë të tjerë. Nga Besiana janë vëllezërit Xhaka dhe vëllezërit Ajeti që kanë bërë emër në futbollin ndërkombëtar. Besiana ishte bërë qendër e shovinizmit dhe çetnikizmit serb të cilët e kishin në posedim qendrën e qytetit, kurse shqiptarët jetonin në periferi, me përjashtim të familjes së Shaban Bajgorës, babushit tim të ndjerë, e cila ishte enklavë e vetme shqiptare në qendër të Besianës. Për atë kohë Besiana ishte qendër e organizuar mirë, me lumin Llap i pastër si loti ku laheshim dhe peshkonim peshq, me një park të mrekullueshëm i cili u degradua sot e që nuk i ngjanë një parku të dikurshëm me asgjë, me një rrugë kryesore, me blinj të shumtë që, përveç aromës, na shërbente edhe për dimër duke e përdorur çajin e blirit. Klubi i Futbollit Llapi e, më vonë, edhe ai i hendbollit kishin respekt në Kosovë dhe kishin shikues besnikë dhe lirisht mund të thuhet se më shumë shikues kishin atëherë këto dy klube sesa që kanë sot

së bashku. Në Besianë ishin disa familje me traditë e që respektoheshin midis vetes, sikur të ishin një familje. Ishin familja Fusha, Çitaku, Simnica, Lepaja, Muçolli, Blakçori që ishin bërthama e Besianës e që më vonë kjo strukturë ndryshoi për shkak të lëvizjeve të popullatës në kërkim të një perspektive apo jete më të mirë. Në Besianën e atëherëshme kishte bohëmë që jetonin nën ndikimin e zhvillimeve në Evropë, duke filluar me ata që e dëgjonin muzikën rok përmes valëve të Radio - Luksemburgut dhe patriotëve që e dëgjonin Radio - Kukësin e që përndiqeshin nga regjimi i Serbisë. Pionierët e bohemizmit në Llap ishin Agim Çavdërbasha që bëri emër ndërkombëtar në fushën e skulpturës, Avdush Hasani, artist me famë botërore dhe Shaip Çitaku që bëri emër në grafikë. Këta e jetonin jetën ashtu si donin, pa iu nënshtruar skemave të atëherëshme që ishin etabluar si standard moral i të jetuarit e që ishte shndërruar në arketip për vlera në një mjedis të rrënuar në aspektin social dhe material. Këtyre musketarëve të parë të bohemizmit nuk u interesonin paratë, prandaj u desh ta paguajnë një çmim për jetën që e zgjodhën. I pari ndërroi jetë Avdush Hasani, pastaj edhe Agim Çavdarbasha duke e lënë Shaip Çitakun (baba i ambasadores Vlora Çitaku), pa krahë dhe pa motiv për ta vazhduar atë stil të jetës. Krahu i Radio - Kukësit identifikohet me Xhemajl Zeqirin (gjyshin e këngëtares Dafina Zeqiri) i cili, kulmin e shtëpisë ku jetonte me bashkëshorten Zizen, katër vajzat dhe dy djemtë, e kishte mbjellë me shumë antena dhe gjatë çdo feste kombëtare, Xhemajli arrestohej dhe mbahej në burgun e Besianës. Edhe gjatë çdo vizite që i bënte Kosovës kriminelit Tito dhe kriminelët e tjerë, "kukojani" Xhemajl izolohej, deri në përfundim të vizitës. Ndonëse i pa shkollë, kur shkonim në shtëpinë e tij, ai na mbante orë të historisë duke i treguar fotot e personaliteteve të shquara kombëtare. Xhemajl Zeqiri ka mbetur i tillë deri kur ndërroi jetë. Gjenerata e patriotëve të rinj të frymëzuar nga Met

Podjeva, Jahja Fusha, Xhemajl Zeqiri dhe, mbi të gjitha, nga Baca i Madh, Adem Demaçi, ishin Shaban Shala, Xheladin Rekalii, Hamit Berberi, Hakif Sheholli dhe të tjerët e vazhduan, me të gjitha sakrificat që duhej bërë në rrugën e frymëzuesve. Shumë shkurtime për një të kaluar patriotike, politike, kulturore dhe sportive të Besianës.

Në atë kohë kishte respekt për ata që duhej respektuar. Skuqeshim në rrugë kur takonim mësuesin e parë, Shaban Zebica apo mësuesen Nexhmije. Bënim vizita të rregullta te Xhemajl Zeqiri kurse, për ta uruar Bajramin, fëmijët e familjes sime së pari e vizitonim inxhen Zejnije (gjyshen e Anita Haradinajt), pastaj familjen tonë të ngushtë. Kur bohëmët e parë të Llapit më merrnin gjatë pelegrinazhit të tyre te lumi Llap, që për ne kishte kuptimin që e ka lumi Nil në Afrikë, ku pinin birra dhe luanin shah, ndihesha si zot i vogël. Realisht, luaja mirë shah dhe në të shumtën e rasteve i fitoja lojërat. Thuaja për çdo ditë luanim futboll të vogël në oborrin e shkollës fillore ku vokrrollët dhe Ragip Çitaku dominonin dhe bënin shou. Ragipi kishte një vëlla më të vogël, të talentuar, Fitimin, i cili vdiq shumë i ri. Të njëjtin që luanim futboll, gjatë dimrit skijonim te Kisha e Podujevës, me ski të punuara nga tarabat e Nikollës që ia shkullnim. I fusnim në një kusi me ujë të vluar dhe pastaj bënim përpjekje t'ua japim formën e skive.

Fadil Vokrri ishte bindshëm më i miri në futboll të vogël apo fushball siç e quanin atëherë. Kishte këmbë si shtylla graniti dhe nuk kishte gjasa ta rrëzoje apo t'ia merrte topin. Pastaj kaloi në Prishtinë, ku u bë yll i vërtetë, për të kaluar në Partizanin e Beogradit. Ne atëherë, ndonëse ishim të padijshëm për politika të mëdha, bënim tifo për klubet e ligës së parë të ish-Jugosllavisë në bazë të preferencave politike. Ata që e donin më shumë pjesën serbe të Jugosllavisë kryesisht ishin me Partizanin apo Crvena Zvezden kurse ne, "patriotët", ishim me Dinamon e Zagrebit apo Hajdukun e Splitit. Naivë ishim në atë kohë, u përmirë-

suam pakëz më vonë.

Kur Fadili luante në Beograd dhe për Jugosllavinë ne e donim dhe brohorisnim për të se ishte shqiptar dhe binim në dëlir kur shënonte gol (i shënonte shpesh) sikur kur "tranoheshim" kur Nazif Gashi e mundi Beneshin apo kur Bogujevci, Hashani, Xhevdet Peci dhe Aziz Salihu i rrihnin ata që ne nuk mund t'i rrihnim e kishim shumë dëshirë t'i rrihnim.

Fadil Vokrri ishte futbollist i jashtëzakonshëm i cili, po ta kishte disiplinën e të bërit jetë sportive dhe të ushtronte si e bën Ronaldo, sot do të ishte në pesëshen e futbollistëve më të mëdhenj botërorë. Fadil Vokrri, Ismet Bogujevci, Afrim Kusia, Luli dhe disa të tjerë ishte vala tjetër e bohëmëve të Llapit, tash në rrethana të tjera dhe mundësi të tjera. Nëse Ismeti, një këngëtar i mrekullueshëm, Fadili, futbollist par excellence, Afrimi, këngëtar i mbushur me zë eksploziv dhe Luli, futbollist shumë i mirë, do të ishin dhënë ekskluzivisht pas të mirave materiale, Behgjet Pacolli dhe Ramiz Kelmendi sot do të ishin shëgert të tyre. Ismeti nuk ka pranuar kurrë, për asnjë çmim ta këndoje muzikë tallava për të fituar lekë, por ka kënduar muzikë të pastër shqiptare për qejfin e shoqërisë me të cilët e ka kaluar një gjysmë shekulli jetë e në mesin e tyre ka qenë edhe Fadili. Me Fadilin jemi rritur sikur edhe me Ismetin, ndërsa edhe raportet familjare i kemi shumë korrekte. Për Fadilin flasin ata që e kanë dashur, e kanë respektuar, e kanë njohur dhe kanë ndjerë dhimbje të sinqertë me vdekjen e hershme, kurse për mua është shumë brengosëse që për Fadilin sot po flasin profiterët politikë që për së gjalli nuk ia kanë varur fare apo që kanë bërë përpjekje ta përmbysin nga posti që e ka pasur e tash, duan të vdesin për hidhërimin e madh që e kanë përjetuar për vdekjen e këtij mjeshtri të futbollit.

Ceremonia e varrimit të Fadil Vokrit është dashur të bëhet nën përkujdesje të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport e kurrsesi nga Kuvendi i Kosovës. Kuvendi i Kosovës duhet të merret me këso ceremonish. Mos e dhashtë Zoti t'i

ndodhë diçka Milaim Zekës, Zafir Berishës, Haxhi Shalës, Ganimete Musliut, Danush Ademit apo Sllobodan Petroviqit. Kurse, për Duda Baljen as që duhet biseduar, prandaj një lutje deri në qiell: O Zot, ruaje Duden e për të tjerët, nëse të mbetet kohë e tepërt!

Te ne është bërë si rregull që dikë e vlerësojmë vetëm kur të vdesë apo kur na duhet për përfitime politike. Prandaj edhe gruaja po më thotë shpesh: "ishalla martohesh edhe një herë, për të më vlerësuar si duhet...". Punë që nuk bëhet, martesë për herë të dytë është sikur ta siguron një "apartament" të përjetshëm në Alkatraz.

Dy miq të mi të idealit, sakrificës, bashkëpunimit e që lë të kuptohet se jemi tre shpirtra binjakë: Shkëlqesia e Tij, presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe Z/kryeministri i Parë (para Enver Hoxhës) dhe ministri për Punë të Jashtme, z. Behgjet Pacolli dhe unë, (kurrkushi), reagan shpejt, e shpallën të dielën si Ditë Zie kombëtare. Nga ky gjest i të parëve të Kosovës kam mbetur pa gjumë. Të fortë janë, të fortë!

Asnjëri nuk e di datën kur kalon nga një gjendje e përkohshme, në një gjendje të përhershme. Dhe mirë është se është kështu sepse, po të ishte ndryshe, të gjithë do të vdisnim, përveç deputetëve të Kuvendit të Kosovës që janë të pavdekshëm. E në veçanti grupi që po lobon për v(m)iza. Nuk e di nëse do të jetoj edhe 20 vjet, 30, 40 apo dyzet ditë. Por, e kam një dëshirë që të mos vdes sa të jenë në pushtet Hashimi dhe Begja sepse, Begja nuk do të shpallte as 10 minuta ditë zie për mua, që e vlerësoj dhe plotësisht do të jetë e pranueshme, kurse Hashimi, në fejsbukun e vet, do të shkruante aso fjalë për mua me të cilat fëmijët e mi do të binin në dilemë nëse unë kam qenë vërtetë baba i tyre! Apo, do të ma rreshtonte familjen sikur dikur në talim, do t'ua ndante një znaçkë e do të urdhëronte të më varrosin me nderime shtetërore sipas Protokollit të Gjylekarës dhe me orkestrën e Muçivërcës! Ta shohim nëse kjo dëshirë do të më plotësohet!

ShBA-ja dhe Koreja Veriore angazhohen për paqe në Gadishullin Korean



Trump tha se të dy udhëheqësit "kanë çuar përpara një lidhje të veçantë" dhe se pas disa orësh bisedimesh të martën dhe nënshkrimit të marrëveshjes ai mendon se marrëdhënia e ShBA-së me Korenë e Veriut do të jetë shumë më ndryshe nga ajo e së kaluarës.

Të dy udhëheqësit, Trump dhe Kim, shprehën mirënjohje reciproke ndaj njëri-tjetrit për takimet dhe presidenti Trump tha se absolutisht do të ftojë Kim Jong Unin për ta vizituar Shtëpinë e Bardhë. "Sot patëm një takim historik dhe kemi vendosur të lëmë pas të kaluarën", tha Kim duke folur përmes një përkthyesi. "Bota do të shohë një ndryshim të madh", tha ai. Menjëherë pas ceremonisë së nënshkrimit Kim u largua nga ishulli Sentosa i Singaporit.

Takim historik

Të dy udhëheqësit u takuan të martën, fillimisht kokë me kokë për 40 minuta, në prani vetëm të përkthyesve të tyre, përpara se me ta të bashkoheshin, për një drekë pune, delegacionet respektive. Pas drekës ata ecën në këmbë së bashku, duke u ndalur shkurtimisht për ta parë limuzinën e veçantë të presidentit të ShBA-së. "Ne patëm një takim me të vërtetë fantastik, shumë përparim, shumë pozitiv", tha Trumpi.

Në delegacionin amerikan ishin sekretari i Shtetit Mike Pompeo, këshilltari për Sigurinë Kombëtare John Bolton dhe Shefi i personelit të Shtëpisë së Bardhë, John Kelly. Në delegacionin e Koresë së Veriut bënte pjesë ish-shefi i zbulimit ushtarak Kim Yong Chol, ministri i Punëve të Jashtme Ri Yong Ho, si dhe Ri Su Yong, nënkryetar i Partisë së Punëtorëve në pushtet.

E marta shënoi takimin e parë midis një presidenti të ShBA-së dhe një udhëheqësi të Koresë së Veriut. Dhjetëra aparate shprehën fotot kur dy burrat u paraqitën së bashku para një sfondi të flamujve të ShBA-së dhe të Koresë së Veriut.

Në dokumentin e nënshkruar nga lideri i Koresë së Veriut, Kim Jong Un dhe presidenti i ShBA-së, Donald Trump, bëhet thirrje që të dy vendet t'i bashkojnë përpjekjet për të ndërtuar një paqe të qëndrueshme në Gadishullin Korean, për të krijuar marrëdhënie të reja mes ShBA-së dhe Koresë së Veriut

e Veriut. "Ne do të dalim nga lojërat e luftës që kushtojnë kaq shumë para", tha ai, duke iu referuar manovrave ushtarake në rajon.

Më herët, në konferencën me gazetarë, Trumpi deklaroi se sanksionet aktuale të ShBA-së do të mbeten për momentin në fuqi deri kur armët bërthamore të Koresë së Veriut të mos jenë më një faktor.

Lidhur me verifikimin e procesit të çnuklearizimit, presidenti Trump tha se ai dhe Kim diskutuan çështjen dhe se përpjekjet për monitorim do të arriheshin duke pasur shumë njerëz atje. Ai parashikoi se Kimi do ta fillonte menjëherë punën për përbushjen e marrëveshjes.

I pyetur nëse bisedimet përfshinin specifika mbi madhësinë e arsenalit bërthamor të Koresë së Veriut, Trumpi tha se "ajo që ata kanë është substanciale". Për të drejtat e njeriut, ai tha se në takimet e së martës tema u prek vetëm shumë shkurtimisht, por se të dyja palët do të diskutojnë për të,

më shumë në të ardhmen. Kur u pyet për mijëra njerëz të burgosur në kampet e punës, Trumpi tha se ai mendon se i ka ndihmuar ata, sepse gjërat në Korenë e Veriut do të ndryshojnë. "Unë mendoj se ata janë një nga fituesit e mëdhenj sot", tha ai.

Lidhje speciale

Presidenti i ShBA-së, në mënyrë të përsëritur, përdori tone pozitive ndaj Kim Jong Unit, duke falënderuar udhëheqësin e Koresë së Veriut për ndërmarrjen e asaj që ai e quajti një hap të guximshëm dhe duke thënë se ai "ka mundësinë të kapë një të ardhme të pabesueshme për popullin e tij".

Ai falënderoi udhëheqësit e Kinës, Japonisë dhe Koresë së Jugut për përpjekjet e tyre për të bërë të mundur takimin e së martës.

Orë më parë, kur u ul pranë Kim Jong Unit, në ceremoninë e nënshkrimit, presidenti

SINGAPOR, 12 QERSHOR - Në një marrëveshje të nënshkruar të martën në Singapor, lideri i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, ritheksoi angazhimin e tij të vendosur dhe të palëkundur për çarmatosjen e plotë bërthamore të Gadishullit Korean, ndërsa presidenti i ShBA-së, Donald Trump, u zotua të ofrojë garanci për sigurinë në Korenë e Veriut.

Të dyja palët premtuan se do t'i vijojnë bisedimet. "Ne do ta çarmatosim nga armët bërthamore Korenë e Veriut", tha Trumpi për "Zërin e

Amerikës". Ai tha se asnjëra nga palët nuk dha ultimatume dhe se marrëveshja e së martës ishte rezultat i muajve të tërë negociatash. "Ju e dini se mund shkonte drejt një lufte. Ju e njihni Korenë e Veriut shumë mirë, Seuli ka 28 milionë banorë, e mund të përfundonte me miliona njerëz të vdekur, por ne e mbyllëm me një marrëveshje", tha ai.

Presidenti Trump tha se trupat e ShBA-së të vendosura në Korenë e Jugut do të qëndrojnë aty, por bëri të ditur një koncesion të kërkuar gjatë nga Koreja

Britania mirëpret përkushtimin e Koresë Veriore për denuklearizim

LONDËR, 12 QERSHOR - Përkushtimi i Koresë Veriore për denuklearizim është shenjë se lideri verikorean Kim Jong Un më në fund ka marrë mesazhin, pas takimit që ka pasur me presidentin amerikan Donald Trump, ka thënë përmes një deklaratë, ministri i Jashtëm britanik, Boris Johnson, transmeton "Reuters". Më herët, Trumpi dhe Kimi kanë premtuar se do të punojnë drejt

denuklearizimit të plotë të Gadishullit Korean, derisa Uashingtoni është treguar i gatshëm për të ofruar siguri. Duke lexuar deklaratën e Johnsonit, zëdhënësi i kryeministres britanike, Theresa May, u ka thënë gazetarëve se "ne mirëpresim mbajtjen e samitit konstruktiv në mes të presidentit Trump dhe Kim Jong Unit". "Ende ka shumë punë për të bërë

dhe ne shpresojmë se Kimi do të vazhdojë të negociojë me qëllim të mirë drejt denuklearizimit të plotë dhe të pakthyeshëm", thuhet në deklaratë.

Trumpi dhe Kimi kanë nënshkruar një dokument të paspecifikuar, pas një takimi ballë për ballë prej 45 minutash dhe bisedimeve më të gjera midis delegacioneve të tyre në një hotel luksoz në ishullin Sentosa të Singaporit.



GRATË SHKRIMTARE

**Elife LUZHA**

Margjinalizimi, apo pengimi i grave që të jenë pjesë e veprimtarive të përbashkëta shoqërore, është jo vetëm shkelje e së drejtës universale ndaj personit femër, por edhe pengesë e zhvillimit dhe përparimit shoqëror, "sepse është e pamundur që një shoqëri të përparojë dhe të qytetërohet me ritmet e kërkutara, në një kohë që njëri nga këto grupe mbetet injorant, dembel apo i paarsimuar", thoshte Sami Frashëri. Duke e ditur se letërsia është "pararjohje e emancipimit", gratë e para shkrimtare në krijimtarinë e tyre letrare shtjelluan kryesisht tematika për emancipimin dhe vetëdijesimin e grave për të drejtat e tyre.

E kur flasim për gratë në letërsi, "emrat e tyre vetejnë në faqet e shtypit, por shumë më rrallë seç do të duhej", thotë shkrimtari ynë I. Kadare në librin e tij "Mëngjeset në Kafe Rostand". Prandaj ai i quan "zonja të vogla të letërsisë", sepse ato nuk mund të bëhen të mëdha nga bërrylat e burrave.

Në fillimet e hershme shkrimet e autoreve nuk përfillshin, madje aftësia e tyre për të shkruar merrej si mangësi, për çka mund të përfundonin edhe në çmendinë. Ishte kjo arsyeja që ato nuk nënshkruheshin me emrat e tyre, por me pseudonime burrash. Aprah Behn është shkrimtarja e parë grua që doli hapur me emrin e vet, edhe pse ndaj saj, Elizabeth Carter e Hannah More, ishte ushtruar presioni i egër për të hequr dorë nga shkrimet.

Epoka "elizabethiane", e njohur si "epoka e Shekspir" (1558-1603) dhe e lulëzimit të romanit, është e shquar me gra romansiere dhe tematikat e tyre për gratë, që patën ndikim edhe në epokën "viktoriane" (1837-1901), kur zunë fill lëvizjet e para feministe më 1850. Po këtë vit në Londër u themelua "Kolegji për vajza". Kurse më 1872 motrat Maria Grej dhe Emilia Shirret themeluan "shkollën publike për vajza".

Xhorxh Eliot (Maria Evans) është një ndër përfaqësueset e kësaj periudhe e cila besonte se "gratë, sipas zotësisë dhe aftësisë, mund të barazohen tërësisht me meshkujt shkrimtarë". Ajo e kishte përkthyer veprën "Jeta e Krishtit" (1846), ku demistifikojë origjinat hyjnore e qenieve, për çka bie në kundërshtim me babanë dhe vëllanë, ndaj detyrohet të largohet nga shtëpia. Në këto kohë dominonte mendimi

paragjykes se "gruaja, nëse donte të mbetej e pastër, duhej t'u shmangej aktiviteteve publike", që tingëllon paradoksale, kur kemi parasysh se në atë periudhë, për 64 vjet (1837-1901), ka udhëhequr mbretëresha Viktoria. Por, siç shkruan më vonë Virginia Vulfi, përkundër pozitës së rëndë të gruas në shoqërinë e asaj kohe, nga fundi i shekullit të 18 kishte ndodhur një ndryshim, kur "gruaja e klasës së mesme po merrej me shkrime". Megjithatë, as gjatë shekullit 19 nuk u arrit shifra 20% e shkrimtareve.

Një tjetër zë i fuqishëm i kësaj periudhe është edhe sociologjia e parë femër Harriet Martino (Martineau), e njohur për veprën "Ilustrimet e ekonomisë politike" që për dhjetë ditë u shit në 1 500 kopje. Ajo publikoi gjithashtu edhe mbi 2 000 artikuj të tjerë me tema për gratë. "Unë prisja kaheër ta fitoj lirinë për të shkruar, thoshte ajo, e bindur se 'Gratë të cilat i përmirësojnë kushtet dhe shanset e gjinisë së tyre, nuk duhet të kenë vetëm dhembshuri dhe përkushtim, por edhe të jenë racionale'. Ishte koha kur në 'Nju Jork Tribunë' u botua raporti mbi 'Konventën e të Drejtave të Femrave', me kërkesë për barazi sociale dhe politike për gratë. Kjo lëvizje gjeti shtrirje sidomos në Angli, me prijësen Harriet Martino, e cila shprehte indinjatë kundër "çdo pjesë tjetër të gjinisë njerëzore që të vendosë për një pjesë tjetër", prandaj thoshte "ne duam të drejta të barabarta dhe trajtim të barabartë për të gjitha privilegjet shoqërore". Është për t'u theksuar se rreth këtyre viteve (1879), Sami Frashëri, në broshurën me titull "Gratë", u bënte thirrje atyre ta ndjekin modelin amerikan për të drejtat e tyre, pasi "gruaja në ShBA nuk është kukull si në Evropë e as robëreshë si në Azi", thoshte ai.

Njihen edhe shumë shkrimtare gra që nëpërmjet artit të shkruar patën rol të veçantë në emancipimin dhe avancimin e të drejtave të femrës në shoqëri. Nismëtarja e letërsisë moderne, anglezja Virxhinia Vullf, në veprën e saj pamflet "Një dhomë për vete", duke analizuar gratë si shkrimtare dhe si personazhe, thotë: "Gruaja duhet të ketë para dhe një dhomë për vete po qe se do të bëjë letërsi". Ajo kishte shkruar një tregim për motrën hipotetike të Shekspir, Juditën, duke shtruar edhe pyetjen: "Nëse Shekspiri do të kishte pasur një motër të talentuar si vetë, a do të mund edhe ajo të bëhej dramaturge apo aktore sikurse i vëllai"? Përgjigja ishte jo, sepse përkundër talentit që mund ta kishte zotëruar, mentaliteti patriarkal dominues nuk do ta lejonte.

Ja pra pse gratë shkrimtare në veprat e tyre nuk firmoseshin me emrin e vërtetë. "Meshkujt i sundojnë femrat në errësirë, fshehurazi dhe vjedhurazi", do të

shprehej më vonë shkrimtarja Simone de Bovuar. Madje, sipas saj, "në asnjë vend statusi legal i gruas nuk është i njëjtë me atë të burrit". Simone de Bovuar në veprën e saj "Seksi i dytë" e kundërshton fuqishëm ndarjen e shoqërisë mbi baza gjinore. Edhe pse nuk e mohonte dallimin mes gjinive, ajo ishte e bindur se gruaja më shumë është produkt i kulturës sesa i natyrës, prandaj thoshte: "Grua nuk lind, por bëhesh". Ajo njihet si luftëtare për emancipimin e gruas. Rreth viteve '70 u angazhua në "Lëvizjen për Çlirimin e Gruas", duke u bërë frymëzuese dhe referencë e lëvizjes feministe në botë.

Gratë e para shkrimtare në letërsinë shqipe

Sipas shkrimtarit tonë Ismail Kadare, letërsia e shkruar artistike te shqiptarët fillon me Lekë Matrëngën, i cili qysh në vargun e dytë të poezisë "Pëshpëritje" (1592) për herë të parë përmend fjalën grua. Pas tij vjen Pjetër Budi që "përbën një nga kulmet botërore në portretizimin e hijeshisë femërore", thotë ai. Edhe në periudhën e Rilindjes, që njihet si periudha e ringjalljes kulturore të shqiptarëve, poetët si Naimi, Çajupi e të tjerë e hyznizuan gruan shqiptare gjer në lartësitë poetike, të paarrishme edhe sot. Ishte kjo koha e pushtimit osman, kur gruaja shqiptare, e mbërthyer nga sundimi i despotizmit oriental, nuk gëzonte asnjë të drejtë. Dhe sikur kjo të mos mjaftonte, gruaja shqiptare po përjetonte edhe tmerrin e mbulimit të detyruar me perçe, "që ishte turpërim i madh dhe betejë e humbur për shqiptarët", thotë Kadare.

Në periudhën e lëvizjeve për çlirim kombëtar të shek. XIX-të, gruaja shqiptare, krahas luftës kundër pushtuesve osmanë, duhej t'i luftonte edhe kodet kanunore që, sipas Edith Durham, "kishin forcë detyruese sa Dhjetë Porositë e Biblës, mësimet e islamit e krishterimit apo ligjet e sheriatit e të kishës". Prandaj, nuk ishte për t'u habitur që poeti anglez Bayron, në veprën e tij "The pligimage of Child Harold" (1812), pozitën e gruas shqiptare e përshkruante si "tamed in their cave", termi "pa kapërdirë", por që, për fat të keq, pasqyron fatin tragjik të femrës shqiptare në atë kohë.

Nga fundi i shek. XIX valët e lëvizjeve feministe në botë u ndien edhe në Shqipëri. Shkrimtarja me origjinë shqiptare, Elena Gjika (Dora d'Istria), ishte një ndër katër gratë më të fuqishme në Evropë (Clara Zetkin, Virxhinia Vullf, Simone de Bovuar), e cila nëpërmjet fjalës së shkruar promovonte të drejtat e grave dhe integrimin e tyre në shoqëri. Në veprën e saj "Gratë të para nga një grua" shkruante se "gruaja shpesh është

sklave e injorancës që të tjerët e lënë me qëllim".

Ndikuar nga kjo frymë, motrat Parashqevi dhe Sevasti Qiriazi, më 23 tetor 1891 në Korçë hapën shkollën e parë shqipe për vajza. "Fillimisht shkollën e vizituan tri vajza, por deri në fund të vitit shkollën e përfunduan edhe 27 të tjera", thotë në kujtimet e veta mësuësja e parë e kësaj shkolle, Sevasti Qiriazi. Ajo kishte studiuar në Stamboll dhe në ceremoninë e diplomimit të saj, si përfaqësues i Ministrisë së Arsimit, merrte pjesë edhe Naim Frashëri, i cili Sevastias i ishte drejtuar me këto fjalë: "Motër, punë më të mirë dhe më të vyer nuk mund të bësh për Shqipërinë sesa vendimi që keni marrë për emancipimin e grave. Po të jesh besnike, këmbëngulëse dhe e vullnetshme do të arrish të kryesh vepra të mëdha për kombin". Sevastia bashkë me tri shoqe shqiptaro-amerikane, në dekadën e parë të shek. XX, në revistën "Përparimi", pos poezisë, publikuan edhe publicistikë, duke u bërë nismëtare te letërsisë së shkruar nga femrat. Thënia e Sevastias "i quaj hero ato që sakrifikojnë veten për hir të tjerëve dhe jo ato që sakrifikojnë të tjerët për hir të vetes", shpreh punën e saj vetëmohuese në mbi 40 vjet në shërbim të arsimit kombëtar.

Pas pavarësisë së Shqipërisë, letërsia shqipe mori një drejtim të ri zhvillimi. Megjithatë emri i gruas letrare thajse nuk dukej gjëkund. Duhej të vinin vitet '30 për t'u dëgjuar zëri i atyre që "sollën pranverë në shtypin shqiptar", si do të shprehej poeti Gjergj Bobani. Selixhe Ciu (1918-2003), një vajzë 17 vjeçe nga Gjirokastra, ishte ajo "lulja e pranverës", e cila, nën pseudonimin "Kolombia", më 28 nëntor 1935 në gazetën "Populli" botoi vjershën "Vala Gënjeshitare". Me një gjuhë të mprehtë poetike botoi edhe poezi të tjera ku shpaloste pikëpamjet për mbrojtjen e të drejtave të grave. Por, një nga zërat dallues që "ua çelën rrugën grave shqiptare në botën e bukur të artit" pa dyshim është Musine Kokalari, e cila, krahas veprave poetike, botoi edhe prozë, ku dominonin temat për pozitën e rëndë të gruas në shoqërinë shqiptare. Veprat e saj u vlerësuan lart nga kritika por, siç ndodh shpeshherë në jetë, "gratë e shquara lihen në mosnjohje". Musineja, e martirizuar nga regjimi komunist, për një kohë të gjatë thua se ishte lënë në anonimitet, për t'u rikthyer prapë përmes veprave me vlera të larta artistike për kombin.

Me kalimin e viteve zëri i shkrimtareve bëhet më i dëgjuar por, si në shumë sfera të jetës, femra vazhdon të diskriminohet dhe nënçmohet. Kultura e të shkruarit e grave "kalohet si të ishte nënkulturë", prandaj ato bëjnë përpjekje titanike për të qenë të barabarta, në fushën që "ende konsiderohet e burrave". Se

kjo qëndron, na e dëshmon periudha e viteve 1950-1980, kur vështirë numëronim mbi dhjetë tituj të librave me autore gra. Sado të pabesueshme të na duken këto të dhëna, për fat të mirë apo të keq, burime të sakta për ne vazhdojnë të mbeten ato të mbledhësve apo albanologëve të huaj, si Robert Elsie, i cili në studimin e tij "Një fund dhe një fillim", gratë shqiptare më shumë i konsideron si gra që shkruajnë sesa gra shkrimtare. Ai ka bërë edhe një renditje të autoreve të para gra ku, sipas tij, prinë Adelina Mamaqi, me veprën poetike "Ëndrra vashërie" (1963), duke vijuar me: Zhuljana Jorgaxhi, Natasha Lako, Adelina Bolashi, Elsa Bollauri, Beatrice Bolliçi, Flora Brovina, Edi Shukriu, për të arritur në vitin 1973 me Elena Kadare dhe romanin "Një lindje e vështirë", që konsiderohet romani i parë në letërsinë shkruar nga femrat shqiptare. Pastaj është Mimoza Ahmeti dhe emra të tjerë të grave letrare, por pa ndonjë "grande dame", siç shprehet ai, sepse "gratë shqiptare deri vonë ishin analfabete". Dhe kjo qëndron kur kemi parasysh se deri në vitet '50 shumica e grave shqiptare nuk dinin shkrim e as lexim.

Duhet thënë se që nga fillimet e viteve '90 numri i shkrimtareve është rritur. Shumë prej tyre tanimë numërojnë dhjetëra tituj librash të botuar. Një paraqitje të emrave të këtyre "zonjave të vogla" të letërsisë shqipe në librin "Mëngjeset në Kafe Rostand" e ka bërë edhe shkrimtari ynë Ismail Kadare, duke filluar me Elvira Dones, Ornela Vorpsi, Luljeta Leshnaku, Ani Wilms, Besa Myftiu, Lindita Arapi etj., "emrat e të cilave kursesi s'mund të jenë shterues", thotë ai. Disa prej tyre (edhe nga të përmendurat), të larguara nga Shqipëria, sidomos pas trazirave të vitit 1997, shkëlqejnë nëpër vendet e ndryshme të Evropës e të botës. Është fatkeqësi fakti që artisti në vendin e vet e ka të pamundur t'i sigurojë kushtet më minimale për jetë. Kjo padrejtësi natyrisht godet edhe krijueset gra, të cilat janë të detyruara të "ikin", si dallëndyshet (siç i përfytyronte Lasgushi, apo si xixëllonjat (siç i përfytyron I. Kadare), për të mbijetuar, bashkë me ëndrrën për kthim.

Në letërsi nuk duhet bërë dallimi midis dy gjinive dhe nuk është mirë të thuhet "letërsi e grave apo e burrave", por nuk mundem pa thënë se në letërsinë shqipe emri i shkrimtareve vazhdon të mbetet i anashkaluar qoftë në ndarjen e çmimeve, pjesëmarrjes në takime, apo edhe vlerësimeve të tjera përkatëse. Është pikërisht ky diskriminim që e bën si të "padukshme" gruan shkrimtare në historinë e letërsisë, që është vetëm një nga "vellot" e errëta të padrejtësive ndaj grave në shoqërinë tonë.

E rrallë

Breshka 45-vjeçare bie në rrjetat e peshkatarëve

Breshka e llojit Kareta-Kareta, me një peshë prej 40 kilogramëve, ka rënë në rrjetat e peshkatarëve të Orikuimit. Peshkatari Sherif Durmishi ka treguar se breshka është rreth 40-vjeçare dhe është e llojit Kareta-Kareta. Sipas tij, breshka nuk ka asnjë shenjë dëmtimi dhe është me shëndet të plotë.



FOTO E DITES



Një djalë në Manila të Filipinës mbahet për një degë peme në lumin që është rritur nga shirat. /AFP/

E jashtëzakonshme Ushtari vjedh tankun dhe del bën xhiro në qytet

Policia amerikane ka arrestuar një ushtar pasi ka vjedhur një automjet të blinduar të Gardës Kombëtare dhe ka dalë duke bërë xhiro nëpër qytet. Policia e ndoqi ushtarin për dy orë në një rrugë me trafik.



BARSOLETA E DITËS



- Mos e lexove mbrëmë një sms?
- Qe m'i lype 50 euro borxh, a?!
- Po.
- Jo, s'e kam pa.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit
në ora 15:00

“AVENGERS: Infinity War” 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

“ISLE OF DOGS”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

“DEADPOOL 2” (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, “DEADPOOL 2” do te shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

“I FEEL PRETTY”

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




DASHI

Hëna në shenjë ju favorizon në çdo aspekt të jetës, por më shumë në atë sentimental. Jeni gjithë kohës në krahët e partnerit dhe ndiheni mjaft mirë.



DEMI

Sot jeni ju protagonistët e ditës në saje të një marrëveshjeje mjaft të favorshme që keni arritur të mbyllni. Do të filloni të merrni përfitime shumë shpejt.



BINJAKËT

Do t'ju duhet të jepni prova që mund të përballojë një situatë stresi pa u alarmuar dhe pa ju zënë paniku. Më përpara nuk keni mundur ta superoni këtë gjë.



GAFORRJA

Çdo gjë që ka lidhje me ju sot do të jetë e ekzagjeruar. Do të luftoni shumë, do të mërztiteni shumë dhe në çdo rast nuk do të ndaloni.



LUANI

Sot do të jeni pak si nervoz për çdo gjë si në familje ashtu dhe në punë. Do të kundërshtoni këdo që do t'ju propozojë diçka që nuk ju pëlqen juve.



VI RGJËR ESHA

Edhe pse keni dyshime në një bisedë të bërë kohët e fundit, nuk do t'i shprehni ato pa u siguruar nëse vërtet qëndrojnë ato për çfarë po dyshoni.



PESHORJA

Është periudha më e mirë për të folur për pushime dhe për udhëtime. Vizitoni kultura të ndryshme dhe merrni me vete edhe miq.



AKREPI

Xhelozitë dhe debatet në çdo moment me partnerin, tregojnë se duhet të vendosni një kufi ose duhet të lini gjithçka dhe të niseni për pushime.



SHIGJETARI

Një ditë shumë e mirë sot për të gjithë ju që keni punuar fort për t'i arritur qëllimet tuaja. Më në fund pak dritë në fund të tunelit.



BRICJAPI

Disi në mënyrë të ndrojtur, por më shumë dashuri do të arrini t'i shprehni ndjenjat njeriut të zemrës. Kjo gjë do t'ju afrojë më shumë bashkë.



UJORI

Një ditë shumë e zakonshme dhe pa asnjë kulm të rëndësishëm. Gjithsesi ju dini të argëtoheni në çdo moment.



PESHQIT

Sot do të shkojë gjithçka siç e keni parashikuar, madje dhe më mirë. Jeni nën një aureole optimizmi që do të bëjë që gjithçka të shkojë në vaj.

Ariana Grande konfirmon lajmin e fejesës



Ariana Grande konfirmon raportimet sa i përket fejesës së saj me komedianin Pete Davidson. Fansat e Grandes kanë filluar diskutimet në rrjetin social në "Twitter" për

dasmën e saj. "Shpresoj që ai të kuptojë se është duke u martuar me të gjithë ne", shkruan një fanse e Grandes në "Twitter". "Ai është i informuar për këtë", u përgjigj 24-vjeçarja.

Bieberi nuk i ndahet modelueses



Këngëtari Justin Bieber dhe modeluesja e famshme Hailey Baldwin fundjavën që lamë pas kanë qëndruar së bashku në Miami. "Sapo mbërritën në Miami, të dy nuk mund të ndaheshin nga njëri-tjetri

për asnjë sekondë", ka treguar një burim për "E! News". Këngëtari dhe modeluesja kanë deklaruar se janë single dhe thjesht po përpiqen ta forcojnë shoqërinë e tyre duke kaluar një fundjavë ndryshe.



Kimi dhe Kylie me forma të ngjashme

Kim Kardashian dhe Kylie Jenneri janë të bekuara me asetet e tyre mahnitëse. Dy motrat e famshme kanë vërtetuar këtë të hënë se kanë forma të

ngjashme teksa janë fotografuar në Cabasas. Yjet e reality shout, të veshura me streçe, dukeshin si të klonuara, ndërkohë që kanë shijuar një ditë së bashku në Kaliforni.

"Nxehet" situata mes yllit të muzikës dhe aktore



Duket sikur situata po nxehet midis yllit të muzikës Nick Jonas dhe aktore Pryanika Chopra. Këngëtari i "Jealous"-it ka ftuar yllin e "Quantico"-s në dasmën e kushëritit të tij Rachel Tamburelli. Nga fotografitë e çiftit që qarkullojnë, shihet aktorja e veshur në një

fustan për raste të veçanta dhe Jonas i veshur në një kostum elegant blu. Fotografitë e çiftit janë publikuar disa ditë pasi janë fotografuar në aeroportin e Nju Jork Cityt. Pas kësaj, ata janë larguar së bashku në një fluturim privat drejtuar festimeve në Atlantic City, New Jersey.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

PARANA - CRUZEIRO

2

AMERICA MINEIRO - CHAPECOENSE

1

FLUMINENSE - SANTOS

1

Drita dhe Prishtina mësojnë kundërshtarët në Evropë

Dy skuadrat më të mira në Kosovë për edicionin 2017/2018, Drita dhe Prishtina, do ta prezantojnë futbollin në garat ndërkombëtare: Ligën e Kampionëve dhe Ligën e Evropës. Shorti i hedhur të martën në Nyon ka dhënë rezultat pozitiv për kampionen dhe fituesen e Kupës së Kosovës, pasi do të përballen me FC Santa Coloma dhe FC Europa

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kampionia e Kosovës në Futboll, Drita nga Gjilani, do ta bëjë debutimin ndërkombëtar ndaj kampionës së Andorrës, FC Santa Coloma. Këtë përballje e vendosi shorti i hedhur të martën në Nyon të Zvicrës, derisa ky është raundi preliminar i Ligës së Kampionëve, kurse ndeshja tjetër është në mes të Fiorita (San Marino) dhe Lincoln Red Imps (Gjibraltari).

Fituesit e raundit në fjalë hyjnë në raundin e parë kualifikues, që do të luhet më 10/11 dhe 17/18 korrik, me kundërshtarët e tyre që do t'i mësojnë nga shorti i datës 19 qershor. Ndërsa tri

ekipet humbëse transferohen në raundin e dytë kualifikues të Ligës së Evropës, pra raundi gjysmëfinal luhet më 26 qershor, kurse ai final më 29 qershor. Lidhur me shortin e hedhur në Nyon ka folur trajneri i skuadrës së Dritës, Bekim Isufi. Edhe ky i fundit debutoi në arenën ndërkombëtare, pas një suksesi të jashtëzakonshëm në postin e trajnerit të Dritës, duke u shpallur kampion i Kosovës. "Skuadrat që marrin pjesë në këto kualifikime janë përafërsisht të njëjta. Kundërshtari ka përparësi përvojën, pasi që 6-7 vjet radhazi merr pjesë, kurse përvoja është hendikepi më i madh yni në këtë garë", ka deklaruar trajneri gjilanas. Pas shortit në Ligën e Kampionëve është hedhur edhe shorti për Ligën e Evropës dhe me

këtë rast Prishtina e ka mësuar emrin e kundërshtarit.

Ndryshe nga Drita, Prishtina në këtë garë merr pjesë për herë të dytë. Kundërshtari i "bardhekaltërve" është skuadra nga Gjibraltari, FC Europa. Kjo skuadër e ka mbyllur kampionatin në pozitën e katërt, kurse nga viti 2014 ka arritur që nga pesë edicione të kalojë një raund në vitin 2016. "Skuadra që vlerësohet si amatore nga 'transfermarkt' ka shumicën e futbollistëve spanjollë, por më të njohurit ka dy ganezë që kanë prekur pak futbollin edhe në Belgjikë e Holandë. Po ashtu, edhe trajneri nuk është i njohur, e që bëhet fjalë për një spanjoll që më parë ka qenë drejtor i klubit", thuhet në njoftimin e FC Prishtina.

SHKURT

Sejdiu, trajner i Vëllaznimit

KF Vëllaznimi ka arritur marrëveshje me trajnerin Gani Sejdiu. Ky i fundit do t'i prijë skuadrës së Vëllaznimit në edicionin e ri 2018/2019. "Presidenti i klubit, Agim Cana, sot ka arritur marrëveshjen me trajnerin Gani Sejdiu, që në sezonin 2018/2019 ta udhëheqë klubin kuqezi drejt Superligës. Nga java tjetër pritet që klubi të përforcohet edhe me 3-4 lojtarë", thuhet në njoftimin e KF Vëllaznimi. Sejdiu edhe në kampionatin e fundit e drejtoi Vëllaznimit në disa ndeshje, por pa mundur ta sigurojë mbijetesën në elitë.

Idrizi largohet nga Kukësi, nisjet për te Llapi

Futbollisti nga Kosova, Bujar Idrizi, e ka zyrtarizuar të martën largimin nga skuadra shqiptare, FK Kukësi. "Ju njoftoj se nga sot nuk do të jem më pjesë e FK Kukësi. Falënderoj për përkrahje presidentin, tifozët, lojtarët që ishin një grup shumë i mirë, në veçanti Besar Musollin", ka thënë Idrizi, i cili pritet të jetë pjesë e Llapit për edicionin e ri të futbollit 2018/2019.

Griezmanni refuzon Barcelonën

Antoine Griezmann ka vendosur përfundimisht të qëndrojë te Atletico Madridi deri në vitin 2023. Francezi është lidhur me një transferim te Barcelona, por në fund ka vendosur t'i mbetet besnik skuadrës së Atleticos. Ky është një lajm i mirë për skuadrën e drejtuar nga Diego Simeone, pasi do të ketë në formacion lojtarin më të mirë.

Rooneyn nuk e dëshirojnë në Everton

Ish-reprezentuesi i Anglisë, Wayne Rooney, pritet të largohet nga Evertoni gjatë afatit kalimtar të verës. "Mirror" raporton se trajneri i ri i Evertonit, Marco Silva, nuk e dëshiron Rooneyn në skuadër për edicionin e ri. E ardhmja e ish-sulmuesit të Manchester Unitedit pritet të jetë skuadra e D. C. United.


Wilder -Joshua përballen në Britaninë e Madhe

Londër, 12 qershor - Deontay Wilder është pajtuar për të dueluar me Anthony Joshuan në Britaninë e Madhe, në një duel që

do t'i unifikojë titujt kampionë bote në peshën e rëndë. "Lajm i rëndësishëm për të gjithë fansat e Joshuas, oferta 50 milionë dollarë

për të dueluar në Amerikë është ende vlefshme. Kemi rënë dakord me ofertën e tyre për të dueluar me Joshuan në Britaninë e

Madhe. Nëse ai preferon Anglinë që të dueloj aty, tashmë ka topin në fushën e tij. Është radha e dytë për të zgjedhur", ka thënë Wilder.



10 sulmuesit më të mirë të Kupës së Botës

MOSKË, 12 QERSHOR - Kupa e Botës është vetëm pak orë larg dhe dihet se sulmuesit do të luajnë rol vendimtar në rezultatin final. Këta janë superyjet e futbollit që paguhën më shumë dhe që fitojnë më

shumë trofe. Për ta fituar Kupën e Botës, zakonisht duhet të kesh një sulmues të madh. Edhe pse mesfusha e Spanjës ka qenë magjike në 2010-n, ata nuk do të kishin shkuar shumë larg pa efika-

sitetin e David Villas para portës. Edhe loja mbrojtëse e Italisë në 2006-n kishte nevojë për mbështetjen e sulmuesve. Dhe Brazili nuk do ta kishte fituar kurrë Kupën e Botës në 2002-shin pa Ronaldon. Kjo

është lista e sulmuesve: Lionel Messi, Neymar, Antoine Griezmann, Luis Suarez, Cristiano Ronaldo, Thomas Muller, Mohamed Salah, Harry Kane, Kylian Mbappe dhe Robert Lewandowski.



Ministri Gashi nënshkruan rregulloren që do t'i eliminojë dukuritë negative në sport

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka takuar anëtarët e Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive i cili përbëhet nga pesë anëtarë. Ky Këshill, i cili është organ i përhershëm me përfaqësim ndërinstitucional, përbëhet nga një anëtar nga Prokuroria e Shtetit i cili edhe do të jetë kryetar i Këshillit Kombëtar, një anëtar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, një nga Komiteti Olimpik i Kosovës, një anëtar nga federata përkatëse dhe një anëtar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ministri Gashi me këtë rast edhe pranoi dhe nënshkroi rregulloren të cilën e kanë punuar grupi punues për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe



Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive. Ministri i uroi anëtarët e Këshillit Kombëtar për marrjen e kësaj detyre të rëndësishme dhe i porositi që me përgjegjësinë më të madhe ta kryejnë atë dhe të angazhohen maksimalisht që t'i eliminojnë dukuritë negative në sport. Ai ka thënë se Këshilli do ta ketë përkrahjen maksimale nga ana e tij dhe e MKRS-së. Rregullorja në fjalë, të cilën ministri ka nënshkruar, përcakton detyrat, përgjegjësitë, kompetencat e këtij Këshilli Kombëtar. Kjo trupë kombëtare mund të hartojë politika dhe strategji

me qëllim të parandalimit të dhunës dhe dukurive të tjera negative në ngjarjet sportive, koordinon dhe bashkërendon aktivitetet për ta parandaluar dhe sanksionuar dhunën dhe dukuritë e tjera negative, identifikon shkaqet dhe faktorët që çojnë në dhunë, vlerëson nëse një ngjarje sportive është me rrezikshmëri të lartë, përcjell nga afër ngjarjet sportive, këshillon organet kompetente për hetimin e dhunës dhe dukurive të tjera negative në sport, bashkëpunon me organizata vendore e ndërkombëtare në shkëmbimin e përvojave për parandalimin e dhunës. Në bazë të rregullores, Këshilli Kombëtar do ta ketë edhe sekretarin e tij që do të jetë një nëpunës i MKRS-së. Kryetari, anëtarët dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar do të kompensohen për mbledhje, të cilat mund të mbahen jo më shumë se dy të tilla brenda muajit.

Lojtari më i shtrenjtë në çdo ekip të Botërorit



MADRID, 12 QERSHOR - Spanjollja "AS", duke iu referuar faqeve të specializuara të vlerësimit të çmimit (vlerës) aktuale të futbollistëve, ka evidentuar lojtarin më të shtrenjtë për çdo kombëtare, që merr pjesë në fazën finale të Botërorit të Rusisë. Kuptohej, në krye të kësaj liste qëndrojnë Lionel Messi i Argjentinës dhe Neymar i Brazilit, të cilët vlerësohen secili nga 180 milionë euro. Pra, për bazë nuk merret shuma e paguar për transferimin e fundit të yllit brazilian të PSG-së, fjala vjen, 22 milionë euro, por vlera momentale e kartonit. Si shqiptarë na nderon fakti se një prej nesh, Granit Xhaka, lojtar i Arsenalit në Premierë Ligë, është më i shtrenjtë te Zvicra, teksa kuotohet në vlerë tregu 40 milionë euro. Përmes një renditjeje zbritëse, nga ai që kushton më pak deri te Messi dhe Neymar, me "valencat" më të krijuara financiare, njihuni me emrat përkatës më poshtë:

LISTA E FUTBOLLISTËVE

Anibal Godoy	(Panama) - 800 mijë euro
Yasir Al-Shahrani	(Arabia Saudite) - 1.5 milion euro
Andre Carrillo	(Peruja) - 6 milionë euro
Sardar Azmoun	(Irani) - 9 milionë euro
Ellyes Skhiri	(Tunizia) - 10 milionë euro
Aaron Mooy	(Australia) - 10 milionë euro
Shinji Kagawa	(Japonia) - 13 milionë euro
Aleksandër Golovin	(Rusia) - 18 milionë euro
Keylor Navas	(Kosta Rika) - 18 milionë euro
Hirving Lozano	(Meksika) - 22 milionë euro
Victor Lindelof	(Suedia) - 25 milionë euro
Wilfred Ndidi	(Nigeria) - 25 milionë euro
Amine Harit	(Maroku) - 25 milionë euro
Gylfi Sigurdsson	(Islanda) - 30 milionë euro
Granit Xhaka	(Zvicra) - 40 milionë euro
Ivan Rakitić	(Kroacia) - 50 milionë euro
Heung-min Son	(Koreja e Jugut) - 50 milionë euro
Luis Suarez	(Uruguai) - 70 milionë euro
Sadio Mane	(Senegali) - 70 milionë euro
James Rodriguez	(Kolumbia) - 70 milionë euro
Sergio Busquets	(Spanja) - 80 milionë euro
Christian Eriksen	(Danimarka) - 80 milionë euro
Toni Kroos	(Gjermania) - 80 milionë euro
Sergej Milinković-Savić	(Serbia) - 90 milionë euro
Robert Lewandowski	(Polonia) - 90 milionë euro
Cristiano Ronaldo	(Portugalia) - 100 milionë euro
Kylian Mbappe	(Franca) - 120 milionë euro
Harry Kane	(Anglia) - 150 milionë euro
Mohamed Salah	(Egjipt) - 150 milionë euro
Kevin De Bruyne	(Belgjika) - 150 milionë euro
Neymar	(Brazili) - 180 milionë euro
Lionel Messi	(Argjentina) - 180 milionë euro

SHKURT

Shaqiri, pas Botërorit, në Liverpool

"Mirror" raporton se Liverpooli do të tentojë ta transferojë mesfushorin e Stoke Cityt, Xherdan Shaqiri, menjëherë pas përfundimit të Kupës së Botës muajin e ardhshëm. Po ashtu, edhe përfaqësuesi zviceran është i gatshëm t'u bashkohet "Të kuqve". Gjiganti nga Premierliga pritet ta transferojë 26-vjeçarin nëse Stoke, që tani do të bëjë gara në një nivel më të ulët të futbollit anglez.

Duranti e mendon pensionimin

Sapo ka fituar titullin e dytë kampion radhazi në NBA me skuadrën e Golden States, por Kevin Durant duket se po mendon edhe për të ardhmen ose, më saktë, për periudhën se kur do ta lërë sportin e basketbollit. Në një intervistë për ESPN, ylli i Warriorsit ka bërë me dije se në moshën 35-vjeçare do të largohet nga sporti. Në kuotën e 20 913 pikëve, Duranti është një nga kandidatët për ta kaluar kuotën e 38 387 pikëve të legjendës Kareem Abdul-Jabbar, por duket se lojtari nuk ka qejf të flasë për rekorde. "Rekordi nuk më intereson. Do të largohem nga basketbolli atëherë kur të kuptoj se do t'i kem arritur dhe do t'i kem fituar të gjitha ato që kam synuar", ka thënë Duranti, që u lë të kuptojë fansave të tij se kur të tërhiqet nuk do të ketë më asnjë arsye për të luajtur. "Në moshën 35-vjeçare besoj se kam moshën e duhur për t'u diplomuar, pasi kam studiuar shumë", ka deklaruar Duranti, aktualisht 29-vjeçar. Për sa i përket karrierës pasi të lërë sportin, shton: "Mund të bëhem trajner, ndoshta menaxher ose të kem një skuadër timen".

Ancelotti: Brazili, favorit në Kupën e Botës

Carlo Ancelotti është një prej trajnerëve më të suksesshëm në Evropë, e jo vetëm, e pa dyshim se parashikimet e tij për skuadrat kanë vlerë. "Brazili besoj se ka më tepër mundësi, duke qenë se trajneri i ri Tite ka ndërthurur një mbrojtje të fortë, e duke marrë në konsideratë sulmin e tyre fantastik, ky miksim i bën më favoritët", ka deklaruar Ancelotti. Por janë edhe dy kombëtare të cilat Ancelotti i evidenton, Belgjika e Kroacia, sipas tij, janë dy ekipet që do ta bëjnë diferencën.

De Gea: E kemi studiuar mirë Ronaldon

Derisa Spanja po përgatitet për t'u përballur me Portugalinë në ndeshjen e saj hapëse në Kupën e Botës, numri një i portës së saj, David De Gea, nënvizoi se "Furia e Kuqe" i ka bërë detyrat e shtëpisë për njeriun e rrezikshëm, Cristiano Ronaldo. Ai beson se ndeshja e parë është gjithmonë e rëndësishme. "Ndeshja e parë është gjithmonë e rëndësishme dhe për më tepër kur luhet kundër një rivali të fortë dhe komplikuar si Portugalia", ka thënë De Gea. Ai thotë se të gjithë e dinë se Cristiano është ndër më të mirët në botë. "Cristiano Ronaldo e kemi studiuar mirë dhe të gjithë e dinë se ai është ndër më të mirët në botë. Pas tij qëndron një ekip i madh. Ata janë kampionë të Evropës dhe do të jetë një ndeshje e vështirë", ka shtuar De Gea.

Ibra nuk e sheh Francën si favorite në Botëror

